



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr.160

14 dhjetor

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr. 7849 datë 4.12.2012	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8619
Vendim i KM nr. 806, datë 3.12.2012	Për shtyrjen e afatit të kryerjes së procedurave të prokurimit për objektet e investimeve, në kuadër të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, për vitin 2012.....	8619
Vendim i KM nr. 807, datë 3.12.2012	Për shtyrjen e afatit të kryerjes së procedurave të prokurimit dhe botimit të njoftimit të fituesit e të njoftimit të kontratës së lidhur, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, si autoritet kontraktor.....	8619
Vendim i KM nr. 810, datë 21.11.2012	Për shtyrjen e afatit të kryerjes së procedurave të prokurimit për objektet e investimeve në fushën e shëndetësisë, në kuadër të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, për vitin 2012.....	8620
Vendim i KM nr. 811, datë 21.11.2012	Për rishpërndarje fondesh për shpenzime kapitale, ndërmjet programeve të miratuara për Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në buxhetin e vitit 2012.....	8622
Vendim i KM nr. 812, datë 21.11.2012	Për një shtesë dhe ndryshim në vendimin nr. 758, datë 2.11.2012 të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë fondesh në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për ekspozitat e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe ekspozitën “Veshje të trevave shqiptare”, në kuadër të 100-Vjetorit të Pavarësisë”.....	8622
Vendim i KM nr. 813, datë 21.11.2012	Për një shtesë në vendimin nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”.....	8623
Vendim i KM nr. 814, datë 21.11.2012	Për shtyrjen e afatit të kryerjes së procedurave të prokurimit, për Këshillin e Lartë të Drejtësisë, si autoritet kontraktor.....	8624

Vendim i KM nr. 815, datë 21.11.2012	Për miratimin e fondit të shpenzimeve të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, për vitin 2013.....	8624
Vendim i KM nr. 816, datë 14.11.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 916, datë 28.12.2011 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2012, në njësitë e qeverisjes qendrore”.....	8625
Vendim i KM nr. 826, datë 21.11.2012	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Pirg të qarkut të Korçës.....	8626
Vendim i KM nr. 828, datë 21.11.2012	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Kodovjat të qarkut të Elbasanit.....	8627
Vendim i KM nr. 829, datë 21.11.2012	Për miratimin e marrëveshjes së grantit nr.TF012599 të Fondit Global të Mjedisit (GEF), ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin e projektit “Rishikimi i strategjisë kombëtare të biodiversitetit e planit të veprimit (SPVB) dhe të raportit të pestë kombëtar për konventën e biodiversitetit (CBD)”.....	8628
Vendim i KM nr. 830, datë 21.11.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 484, datë 23.6.2010 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin e anëtarëve të bordit të menaxhimit për Autoritetin Rrugor Shqiptar”.....	8633
Vendim i KM nr. 831, datë 21.11.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të z. Albert Kryemadhi.....	8634
Vendim i KM nr. 833, datë 21.11.2012	Për miratimin e marrëveshjes së kontributit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEBD), për financimin e projektit “Rehabilitimi i spitalit rajonal të Shkodrës, faza e tretë”, me një grant 50 (pesëdhjetë) mijë euro.....	8634
Vendim i KM nr. 834, datë 21.11.2012	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Berat të qarkut të Beratit.....	8639
Vendim i KM nr. 836, datë 21.11.2012	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Lenie të qarkut të Elbasanit.....	8640
Vendim i KM nr. 839, datë 21.11.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të z. Myzafer Zaimi.....	8641
Vendim i KM nr. 842, datë 14.11.2012	Për disa ndryshime në vendimin nr. 234, datë 6.3.2009 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i nënstacionit elektrik 400/220/110 Kv në Kashar”.....	8641

Vendim i KM nr. 843, datë 2.11.2012	Për krijimin e Shtëpisë Botuese të Teksteve Mësimore (BOTEM)....	8642
Vendim i KM nr. 844, datë 21.11.2012	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënie me koncesion të hidrocentraleve “Vërmik 1, 2 dhe 3” dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë.....	8643
Vendim i KM nr. 845, datë 21.11.2012	Për disa shtesa e ndryshime në vendimin nr. 428, datë 9.6.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”.....	8643
Vendim i KM nr. 846, datë 21.11.2012	Për caktimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve e strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Europian, në kuadër të instrumentit të parazgjerimit (IPA), për zhvillimin rural, komponenti V.....	8646
Vendim i KM nr. 847, datë 4.12.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Punëve të Jashtme, për Westminster Council, për projektin “Vendosja e bustit të Skënderbeut në Londër, në nëntor 2012”.....	8653
Vendim i ERRU nr. 26, datë 13.11.2012	Për rinovim licence sh.a. “Ujësjetllës Peshkopi”.....	8654
Vendim i ERRU nr. 27, datë 13.11.2012	Për rinovim licence sh.a. “Ujësjetllës-kanalizime Krujë”.....	8654
Vendim i ERRU nr. 28, datë 19.11.2012	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. UK Pogradec.....	8655
	Vendim për heqjen e zotësisë për të vepruar për shtetasin Ndriçim Hida.....	8655

DEKRET
Nr. 7849, datë 4.12.2012

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 pika 7, e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar në propozimet e Ministrisë të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Ramadan Hysen Alaj
2. Azem Sokol Brahim

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 806, datë 3.12.2012

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR
OBJEKTET E INVESTIMEVE, NË KUADËR TË FONDIT TË ZHVILLIMIT TË RAJONEVE,
PËR VITIN 2012**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e autoriteteve kontraktore për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, si dhe për lidhjen e kontratave përkatëse për investimet sipas vendimeve të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve, deri më 31 dhjetor 2012.

2. Ngarkohen njësitë e qeverisjes vendore, autoritetet kontraktore dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 807, datë 3.12.2012

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT DHE
BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT E TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR,
PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERTARE, SI AUTORITET KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, si autoritet kontraktor, të përfundojë brenda datës 20 dhjetor 2012, realizimin e procedurave të prokurimit, me objekt “Rikonstruksion i vilës qeveritare nr. 4, Tiranë” dhe “Rikonstruksion i pjesshëm i Pallatit të Kongreseve”, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit, për vitin 2012, sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Brenda këtij afati të përfshihen shpallja e njoftimit të fituesit, lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratave të nënshtruara në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Agjencia e Prokurimit Publik dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI NR. 1

1. “Rikonstruksion i vilës nr. 4”, Tiranë, fondi limit 48.768.665 lekë me TVSH.
2. “Rikonstruksion i pjesshëm i Pallatit të Kongreseve” Tiranë, fondi limit 10.507.968 lekë me TVSH.

VENDIM

Nr. 810, datë 21.11.2012

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR OBJEKTET E INVESTIMEVE NË FUSHËN E SHËNDETËSISË, NË KUADËR TË FONDIT TË ZHVILLIMIT TË RAJONEVE, PËR VITIN 2012

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e njërive të qeverisjeve vendore (bashki/komuna), si autoritete kontraktore, të përfundojnë, brenda datës 15.12.2012, realizimin e procedurave të prokurimit për ndërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve të shërbimit parësor, me fondet e zhvillimit të rajoneve, të miratuara në buxhetin e vitit 2012, sipas aneksit 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi. Brenda këtij afati përfshihen dhe lidhja e kontratave, ekzekutimi i punimeve dhe financimi i vlerës së akorduar për vitin 2012.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, njësitë e qeverisjeve vendore dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1

Tabela e financimit të projekteve nga FZHR-ja në zbatim të vendimit nr. 8, datë 5.10.2012
Miratuar me shkresë nga Ministria e Financave me nr. 16755/1, datë 29.10.2012
në lekë

Entiteti i Qev.	Ministria e linjës	Kod institucioni	Emër institucioni	Debiti i v.2012	Emërtimi i projektit
1	2	3	4	5	6
			Totali	47.101.469	
306	13	2306001	komuna.Sinje	1.000.000	Ndërtim ambulance A2 në fshatin Kamçisht, komuna Sinjë
306	13	2306001	komuna.Sinje	1.000.000	Ndërtim ambulance A2 në fshatin Paftal, komuna Sinjë
305	13	2305001	komuna Lumas	1.000.000	Ndërtim ambulance A2 në fshatin Koritëz, komuna Lumas
744	13	2744001	komuna Vendreshe	474.000	Rikonstruksion i ambulancës në fsh.Vendreshë 1, komuna Vendreshë
353	13	2353001	komuna Kala e Dodës	1.000.000	Ndërtim ambulance A2 në fshatin Shullan, komuna Kala e Dodës
647	13	2647001	komuna Baz	1.050.000	Ndërtim ambulance A2 në fshatin Karicë, komuna Baz
367	13	2367001	komuna Gjepalaj	1.500.000	Ndërtim ambulance A1 në fshatin Kënetë, komuna Gjepalaj
524	13	2524001	komuna Cudhi	1.000.000	Rikonstruksion i qendrës shëndetësore në Nuaje komuna Cudhi
152	13	2152001	Bashkia Belsh	1.000.000	Rikonstruksion i qendrës shëndetësore në bashkinë Belsh
387	13	2387001	komuna Gjergjan	1.500.000	Ndërtim ambulance A1 në fshatin Kodër Bujaras, komuna Gjergjan
399	13	2399001	komuna Tregan	936.000	Rikonstruksion i qendrës shëndetësore në fsh.Tregan, komuna Tregan
386	13	2386001	komuna Gjinar	2.658.766	Rikonstruksion i qendrës shëndetësore në fsh.Gjinar, komuna Gjinar
430	13	2430001	komuna Pishaj	1.000.000	Ndërtim ambulance A2 në fshatin Strar, komuna Pishaj
684	13	2684001	komuna Sheze	1.448.000	Ndërtim ambulance A1 në fshatin Pekisht, komuna Sheze
613	13	2613001	komuna Tërbuf	4.500.000	Rikonstruksion i qendrës shëndetësore në fsh.Tërbuf, komuna Tërbuf
112	13	2112001	Bashkia Patos	502.000	Rikonstruksion i qendrës shëndetësore në fsh.Dukas, Bashkia Patos
451	13	2451001	komuna Picar	1.500.000	Rikonstruksion i qendrës shëndetësore në fsh.Picar, komuna Picar
451	13	2451001	komuna Picar	1.500.000	Ndërtim ambulance A1 në fshatin Kolonjë, komuna Picar
781	13	2781001	komuna Fshat Memaliaj	1.000.000	Ndërtim ambulance A2 në fshatin Ceril, komuna Fshat Memaliaj
697	13	2697001	komuna Petran	1.000.000	Ndërtim ambulance A2 në fshatin Badelonjë, komuna Petran
821	13	2821001	komuna Bytyç	1.500.000	Ndërtim ambulance A1 në fshatin Prush, komuna Bytyç
825	13	2825001	komuna Bujan	1.500.000	Ndërtim ambulance A1 në fshatin Lekurtaj, komuna Bujan
461	13	2461001	komuna Fajzë	960.000	Rikonstruksion i ambulancave në fshatrat Brenogë + Metaliaj, komuna Fajzë
700	13	2700001	komuna Buçimas	1.500.000	Ndërtim ambulance A1 në fshatin Gurras, komuna Buçimas
703	13	2703001	komuna Velçan	1.527.059	Rikonstruksion i qendrës shëndetësore në fsh.Velçan, komuna Velçan
704	13	2704001	komuna Trebinjë	1.500.000	Ndërtim ambulance A1 në fshatin Gur i Bardhë, komuna Trebinjë
337	13	2337001	komuna Hoçisht	2.000.000	Rikonstruksion i qendrës shëndetësore në fsh.Baban, komuna Hoçisht
133	13	2133001	Bashkia Rrëshen	650.000	Rikonstruksion i ambulancave në fsh.Malaj, Bashkia Rrëshen
767	13	2767001	komuna Dajç	1.600.000	Rikonstruksion të ambulancave në fsh.Pentar + Mushan + Q.Dajç, Komuna Dajç
766	13	2766001	komuna Velipojë	580.000	Rikonstruksion të ambulancave në fsh.Luarz + Rec i Ri, komuna Velipojë
765	13	2765001	komuna Bërdicë	650.000	Rikonstruksion të ambulancave në fsh.Trush + Bërdicë, komuna Bërdicë
156	13	2156001	Bashkia Konispol	1.112.822	Ndërtim QSH T2 në fsh. Çiflig, bashkia Konispol
735	13	2735001	komuna Markat	1.500.000	Ndërtim ambulance A1 në fshatin Janjar, komuna Markat
325	13	2325001	komuna Vergo	1.000.000	Rikonstruksion ambulance në fsh.Vergo, komuna Vergo
812	13	2812001	komuna Krrabë	1.752.822	Rikonstruksion + shtesë kati për QSH në Krrabë, komuna Krrabë
811	13	2811001	komuna Farkë	1.200.000	Ndërtim QSH T1 në fsh.Farkë, Kom.Farkë



VENDIM
Nr. 811, datë 21.11.2012

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH PËR SHPENZIME KAPITALE, NDËRMJET
PROGRAMEVE TË MIRATUARA PËR MINISTRINË E MJEDISIT, PYJEVE DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE, NË BUXHETIN E VITIT 2012**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve për shpenzime kapitale, ndërmjet programeve të miratuara për Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në buxhetin e vitit 2012, si më poshtë vijon:
 - a) Në programin “Administrimi i pyjeve”, për projektin “Zhvillimi i burimeve natyrore”, për kosto lokale, shtohet fondi në vlerën 3 300 000 (tre milionë e treqind mijë) lekë;
 - b) Në programin “Mbrojtja e mjedisit”, për projektin “Transformim i tregut për panelet diellore (ndryshimet klimatike)”, për kosto lokale, pakësohet fondi në vlerën 3 300 000 (tre milionë e treqind mijë) lekë.
2. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 812, datë 21.11.2012

**PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 758, DATË 2.11.2012 TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE “PËR NJË SHITESË FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR EKSPozITAT
E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE DHE EKSPozITËN “VESHJE TË
TREVAVE SHQIPTARE”, NË KUADËR TË 100-VJETORIT TË PAVARËSISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 758, datë 2.11.2012 të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në titullin e vendimit, pas emërimit “... Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ...” shtohet emërtimi “... Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave ...”.

2. Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Institucioneve të mëposhtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, t’u shtohen fondet, si më poshtë vijon:

a) Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në zërin “Projekte” artikulli 604, t’i shtohet fondi prej 720 000 (shtatëqind e njëzet mijë) lekësh, sipas listë-preventivit bashkëlidhur, për organizimin e ekspozitës etnografike mbarëkombëtare “Veshje të trevave shqiptare”, që do të zhvillohet në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar me rastin e 100-Vjetorit të Pavarësisë.

b) Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave t’i shtohet fondi prej 1 900 000 (një milion e nëntëqind mijë) lekësh, sipas listë-preventivit bashkëlidhur, për realizimin e ekspozitave për 100-Vjetorin e Pavarësisë.”.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PROJEKTET PËR 100-VJETORIN E PAVARËSISË SË SHTETIT SHQIPTAR
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE

Nr.	Emri i aktivitetit	Data	Vendi	Institucioni zbatues	Shuma
1	Ekspozitë “Plava dhe Gucia në 100-Vjetorin e Pavarësisë”	27 korrik	Plavë, Mal i Zi	AQSH	150.000
2	Ekspozitë “Marrëdhëniet shqiptaro-ruse në arkivat e dy vendeve tona”	26 tetor	Tiranë	AQSH	150.000
3	Ekspozitë “Elbasani në 100-Vjetorin e Pavarësisë”	30 tetor	Elbasan	AQSH	150.000
4	“Transmetimi i kujtesës së Holokaustit dhe parandalimi i krimeve kundër njerëzimit”, organizuar në kuadër të presidencës së KE-së (Konferencë, Workshop)	3-5 shtator	Tiranë	AQSH	100.000
5	Ekspozitë “Nderi i njeriut: Shpëtimi i hebrenjve në Shqipëri”	3-5 shtator	Tiranë	AQSH	150.000
6	Përrurimi i ekspozitës mbi kontributin e kolonive shqiptare të mërgimit “Diaspora”	19-26 prill	Tiranë	AQSH	150.000
7	Ekspozita “Kontributi i personaliteteve të SHBA-së dhe Britania e Madhe për çështjen shqiptare”	22 tetor	Tiranë	AQSH	150.000
8	Ekspozitë “Kontributi i personaliteteve nga Franca dhe Gjermania për çështjen shqiptare”	5 nëntor	Tiranë	AQSH	150.000
9	Ekspozitë “Kontributi i personaliteteve nga Austro-Hungaria dhe Italia për çështjen shqiptare”	12 nëntor	Tiranë	AQSH	150.000
10	Katalogët e ekspozitave		Tiranë	AQSH	300.000
11	“Arkivi Shqiptar” – revistë shkencore	nëntor	Tiranë	AQSH	200.000
12	Katalogët e ekspozitës “Dorëshkrime bizantine dhe pasbizantine në Shqipëri”	nëntor	Tiranë	AQSH	100.000
	SHUMA TOTALE				1.900.000 lekë

VENDIM

Nr. 813, datë 21.11.2012

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 997, DATË 10.12.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR TRAJTIMIN FINANCIAR TË PUNONJËSVE QË DËRGOHEN ME
SHËRBIM JASHTË QENDRËS SË PUNËS, BRENDË VENDIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Në kreun III të vendimit nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave, pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Përfshihen nga pika III-1 edhe punonjësit e Qendrës së Shërbimit Mjekësor (Klinika Qeveritare), kur shoqërojnë personalitetet e larta të vendit. Në këto raste, këta punonjës trajtohen sipas pikës III-3 të këtij vendimi.”.

2. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 814, datë 21.11.2012

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT, PËR
KËSHILLIN E LARTË TË DREJTËSISË, SI AUTORITET KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si autoritet kontraktor, të përfundojë, brenda datës 20.12.2012, realizimin e procedurave të prokurimit për objektet “Blerje pajisjesh kompjuterike”, “Riparim automjeteve” dhe “Blerje karburanti”, me fondet e akorduara në buxhetin e vitit 2012.

Brenda këtij afati përfshihen shpallja e njoftimit të fituesit, lidhja e kontratave përkatëse dhe njoftimet e kontratave të nënshkruara.

2. Ngarkohen Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 815, datë 21.11.2012

**PËR MIRATIMIN E FONDIT TË SHPENZIMEVE TË ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT
TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA,
PËR VITIN 2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 11 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, për vitin 2013, në shumën 44 103 000 (dyzet e katër milionë e njëqind e tre mijë) lekë, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Pasqyra nr. 1

Projektplani i shpenzimeve për vitin 2013

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Në lekë
1	Shpenzime për paga	23 183 000
2	Sigurime shoqërore	2 836 000
3	Shërbime e furnitura	12 000 000
4	Investime	6 084 000
	TOTALI	44 103 000

VENDIM

Nr. 816, datë 14.11.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 916, DATË 28.12.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË
PËRKOHSHME PËR VITIN 2012, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 11 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr. 916, datë 28.12.2011 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2012, në njësitë e qeverisjes qendrore, bëhet 740 punonjës. Shtesa prej 100 punonjësish është dhënë me hollësi sipas lidhjes nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përballohen vetëm nga të ardhurat e vetë institucionit.

3. Ngarkohet Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale të depozitojë pranë Ministrisë së Financave të dhëna të hollësishme për numrin e punonjësve, në përputhje me kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 1703, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale/të përkohshme për ministrinë dhe institucionet buxhetore”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e miratimit të tij.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



Gr.	Emri i institucionit	Nr. i punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
06	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit	100			
	ALUIZNI, nga ku:	100	specialistë/ndihmës specialistë	8 orë/ditë	15.11.2012-31.12.2012
	Zyra qendrore e ALUIZNI-t Tiranë	4	specialistë/ndihmës specialistë	8 orë/ditë	15.11.2012-31.12.2012
	Zyra rajonale e ALUIZNI-t Tiranë	24	specialistë/ndihmës specialistë	8 orë/ditë	15.11.2012-31.12.2012
	Zyra rajonale e ALUIZNI-t Durrës	12	specialistë/ndihmës specialistë	8 orë/ditë	15.11.2012-31.12.2012
	Zyra rajonale e ALUIZNI-t Elbasan	12	specialistë/ndihmës specialistë	8 orë/ditë	15.11.2012-31.12.2012
	Zyra rajonale e ALUIZNI-t Korçë	4	specialistë/ndihmës specialistë	8 orë/ditë	15.11.2012-31.12.2012
	Zyra rajonale e ALUIZNI-t Shkodër	5	specialistë/ndihmës specialistë	8 orë/ditë	15.11.2012-31.12.2012
	Zyra rajonale e ALUIZNI-t Lezhë	4	specialistë/ndihmës specialistë	8 orë/ditë	15.11.2012-31.12.2012
	Zyra rajonale e ALUIZNI-t Vlorë	14	specialistë/ndihmës specialistë	8 orë/ditë	15.11.2012-31.12.2012
	Zyra rajonale e ALUIZNI-t Fier	12	specialistë/ndihmës specialistë	8 orë/ditë	15.11.2012-31.12.2012
	Zyra rajonale e ALUIZNI-t Kukës	1	specialistë/ndihmës specialistë	8 orë/ditë	15.11.2012-31.12.2012
	Zyra rajonale e ALUIZNI-t Dibër	2	specialistë/ndihmës specialistë	8 orë/ditë	15.11.2012-31.12.2012
	Zyra rajonale e ALUIZNI-t Gjirokastrë	2	specialistë/ndihmës specialistë	8 orë/ditë	15.11.2012-31.12.2012
	Zyra rajonale e ALUIZNI-t Berat	4	specialistë/ndihmës specialistë	8 orë/ditë	15.11.2012-31.12.2012

VENDIM

Nr. 826, datë 21.11.2012

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS PIRG TË QARKUT TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Pirg të qarkut të Korçës, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Pirg të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr. 1421, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Pirg të qarkut të Korçës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Pirg për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Pirg

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
97-103	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
88-96	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
123-133	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shërbimit funeral	Në pronësi
104-112	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
113-118	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
119-121	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile	Në pronësi
122	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve sociale	Në pronësi
134-135 (pjesa që i përket komunës)	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
262-297	Infrastrukturë vendore (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
136-150	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
151-157,179,187,205,206,222, 226,235,246,259,261	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi
300-353	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM

Nr. 828, datë 21.11.2012

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS KODOVJAT TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë së Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Kodovjat të qarkut të Elbasanit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 101 (njëqind e një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 693 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre).



2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Kodovjat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Kodovjat

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
361-375	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
376-378	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
379-382,383/1,383/2,384	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
385-386,388-391,395-411, 413,446	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
387,462-472	Varrezat publike	Në pronësi
437-445,447-453,459-461	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
457	Prona që përdoren për realizimin e programeve administrative	Në pronësi
475,476	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim Sip.35 ha, fshati Bërsnik i Sipërm dhe 64 ha, fshati Bërsnik i Poshtëm janë dorëzuar në AKKP.
477	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
538-652,656-693	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi

VENDIM

Nr. 829, datë 21.11.2012

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT NR.TF012599 TË FONDIT GLOBAL TË MJEDISIT (GEF), NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD), PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “RISHIKIMI I STRATEGJISË KOMBËTARE TË BIODIVERSITETIT E PLANIT TË VEPRIMIT (SPVB) DHE TË RAPORTIT TË PESTË KOMBËTAR PËR KONVENTËN E BIODIVERSITETIT (CBD)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit nr. TF012599 të Fondit Global të Mjedisit (GEF) ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin e projektit “Rishikimi i strategjisë kombëtare të biodiversitetit e planit të veprimit (SPVB) dhe të raportit të pestë kombëtar për Konventën e Biodiversitetit”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

BANKA BOTËRORE
BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
SHOQATA NDËRKOMBËTARE E ZHVILLIMIT

1818 H Street N.W.
Washington D.C. 20433
SHBA

(202) 477 – 1234
Adresa me kablo: INTBAFRAD
Adresa me kablo: INDEVAS

23 gusht 2012

SH.T. z.Ridvan Bode
Ministër i Financave
Ministria e Financave
Dëshmorët e Kombit nr. 4
Tiranë
Shqipëri

Dr. Pëllumb Abeshi
Drejtori i Përgjithshëm i Mjedisit
Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
Rruga e Durrësit nr. 27
Tiranë
Shqipëri

Re: Raportet GEF për grantin e konventave nr. TF012599
Rishikimi i Strategjisë Kombëtare të Biodiversitetit dhe Planit të Veprimit, duke përfshirë
Raportin e Pestë Kombëtar për Konventën mbi Projektin e Diversitetit Biologjik.

Shkëlqesi:

Në përgjigje të kërkesës për asistencë financiare, të bërë në emër të Republikës së Shqipërisë (Marrësi) kam kënaqësinë t'ju informoj se Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), përfaqësuar nga administratori/kryetari (CEO) i Lehtësisë Globale të Mjedisit (GEF), propozon që t'i japë Marrësit një grant nga raportet për dritaren e konventave të fondit trust GEF në një shumë që nuk i tejkalon dyqind e njëzet mijë dollarë amerikanë (U.S. 220.000\$) (grant) me termat dhe kushtet e parashtruara ose që referohen në këtë marrëveshje letër (marrëveshja), e cila përfshin aneksin e bashkëlidhur, për të ndihmuar në financimin e projektit të përshkruar në aneks (projekti).

Ky grant financohet nga fondi trust GEF për të cilin Banka Botërore, si dorëzani i fondit, merr kontribute periodike. Në përputhje me seksionin 3.02 të kushteve standarde (siç përcaktohen në aneksin e kësaj marrëveshjeje), detyrimet e pagesës së Bankës Botërore, në lidhje me këtë marrëveshje, kufizohen në shumën e fondeve të vëna në dispozicion për të, sipas fondit trust GEF dhe të drejtës së Marrësit për të tërhequr paratë e grantit, i nënshtrohet disponueshmërisë së këtyre fondeve.

Marrësi vërteton, duke konfirmuar marrëveshjen e tij më poshtë, se është i autorizuar ta bëjë këtë marrëveshje dhe të kryejë projektin në përputhje me termat dhe kushtet e parashtruara ose të referuara në këtë marrëveshje. Në përputhje me mirëkuptimin e pasqyruar në paragrafët 23-24 të letrës së Këshillit GEF (GEF/C.38/6/Rev.I) për politikën dhe procedurat për ekzekutimin e aktiviteteve të përzgjedhura GEF, Marrësi, gjithashtu, pranon se, në qoftë se ndonjë projekt/program i identifikuar si rezultat i projektit financohet me fondet GEF, projekti/programi në fjalë duhet të jetë në përputhje me kërkesat e aplikueshme mjedisore dhe sociale.

Ju lutem, konfirmoni marrëveshjen e Marrësit për sa më sipër, duke pasur një zyrtar të autorizuar të Marrësit, që të nënshkruajë dhe të vërë datën në kopjen e bashkëlidhur të marrëveshjes dhe t'ia kthejë atë Bankës Botërore. Me marrjen nga Banka Botërore të kësaj kopjeje të kundërfirmosur, kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi pas njoftimit nga Marrësi të përfundimit të procedurave të tij të brendshme; sidoqoftë, me kushtin që oferta e kësaj marrëveshjeje të konsiderohet e tërhequr, në qoftë se Banka Botërore, nuk e merr kopjen e kundërfirmosur të kësaj marrëveshjeje dhe njoftimin përkatës brenda nëntëdhjetë (90) ditësh pas datës së nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje nga Banka Botërore, përjashtuar rastin kur Banka Botërore do të ketë përcaktuar një datë të mëvonshme për këtë qëllim.



E juaja vërtet,
BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga _____

Naoko Ishii

Administratori/kryetari, Lehtësia Globale e Mjedisit

Rënë dakord:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga _____

Përfaqësues i autorizuar

Emri _____

Titulli _____

Data _____

Bashkëlidhur:

1. Kushtet standarde për grantin, të bëra nga Banka Botërore nga fonde të ndryshme, në datën 15 shkurt 2012.

2. Letra e disbursimit e së njëjtës datë si kjo marrëveshje, së bashku me udhëzimet e Bankës Botërore për disbursimin për projektet, datë 1 maj 2006.

GEF – RtC Grant nr. TF012599

ANEKS

Neni 1

Kushtet standarde; përkufizimet

1.01 Kushtet standarde. Kushtet standarde për grantet e dhëna nga Banka Botërore nga fonde të ndryshme, datë 15 shkurt 2012 (kushtet standarde) përbëjnë një pjesë integrale të kësaj marrëveshjeje.

1.02 Përkufizimet. Po qe se nuk e kërkon konteksti ndryshe, termat me germa të mëdha të përdorur në këtë marrëveshje kanë kuptimet që u jepen atyre në kushtet standarde ose në këtë marrëveshje.

Neni 2

Ekzekutimi i projektit

2.01 Objektivi dhe përshkrimi i projektit. a) Objektivi i projektit është për të ndihmuar Marrësin për: i) përgatitjen e një raporti, sipas nenit 26 të Konventës për Biodiversitetin (CBD) (Raporti i Pestë Kombëtar); ii) për rishikimin e strategjive, planeve ose programeve kombëtare (Strategjia Kombëtare e Biodiversitetit dhe Plani i Veprimit (NBSAP)), sipas nenit 6 të CBD-së; dhe iii) marrjen përsipër të një mekanizmi të zyrës së pagesave.

b) Projekti përbëhet nga veprimtaritë e mëposhtme: i) rishikimi dhe vlerësimi i planeve dhe i politikave kombëtare ekzistuese dhe statusi i implementimit të tyre; ii) kryerjen e konsultimeve, duke përfshirë organizatat e shoqërisë civile dhe grupeve vendore dhe ngritjen e ndërgjegjshmërisë së tyre; iii) identifikimi i kërcënimeve ndaj biodiversitetit në nivel kombëtar; iv) vendosja e objektivave, parimeve kombëtare dhe prioritetëve kryesore të strategjisë për implementimin e objektivave të rëna dakord; v) përgatitja e projektdokumentit të strategjisë dhe planit të veprimit; vi) kryerja e konsultimeve kombëtare për të siguruar integrimin sektorial; vii) zhvillimi i një plani për rritjen e kapaciteteve për implementimin për NBSAP-në; viii) kryerjen e një vlerësimi të nevojave teknologjike dhe bashkëpunimin me sektorë të tjerë, të tillë si: bujqësia, pylltaria dhe turizmi për integrimin e biodiversitetit; ix) përpunimi i një strategjie komunikimi dhe i një strategjie asistence; x) identifikimi i masave për përmirësimin e strukturave ekzistuese të koordinimit kombëtar; xi) rishikimi dhe përditësimi i mekanizmit ekzistues i zyrës së pagesave; xii) zhvillimi i treguesve dhe qasjes së monitorimit për NBSAP-në; xiii) përgatitja dhe

depozitimi i raportit përfundimtar të testit kombëtar në sekretariatit e CBD-së me njoftimin e menjëhershëm të Bankës Botërore për këtë depozitim, në përputhje me seksionin 4.03 të kësaj marrëveshjeje; dhe xiv) raporti i NBSAP-së të rishikuar Konferencën e Palëve (siç përcaktohet në CBD), me njoftimin e menjëhershëm për Bankën Botërore për këtë raportim në përputhje me seksionin 4.03 të kësaj marrëveshjeje.

2.02 Ekzekutimi i projektit në përgjithësi. Marrësi deklaron angazhimin e tij për objektivin e projektit. Për këtë qëllim, Marrësi do të kryejë projektin nëpërmjet Ministrisë së tij të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave në përputhje me dispozitat e: a) nenit II i kushteve standarde; b) “Udhëzimeve për parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e financuara nga huat e IBRD-së dhe kreditë dhe grantet IDA”, datë 15 tetor 2006 dhe rishikuar në janar 2011 (Udhëzimet për antikorrupsionin); dhe c) këtë nen II.

2.03 Vizibiliteti dhe vizitat e donatorit. a) Marrësi do të marrë ose do të bëjë që të merren masa të tilla që Banka Botërore mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të identifikuar publikisht mbështetjen e GEF-së për projektin.

b) Për qëllimet e seksionit 2.09 të kushteve standarde, Marrësi, me kërkesën e Bankës Botërore, përfaqësuar nga administratori i GEF-së, do t’u mundësojë përfaqësuesve të GEF-së që të vizitojnë çdo pjesë të territorit të Marrësit për qëllimet që lidhen me projektin.

2.04 Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i projektit. Marrësi do të monitorojë dhe do të vlerësojë ecurinë e projektit në përputhje me dispozitat e seksionit 2.06 të kushteve standarde. Pa kufizim për sa më sipër, Marrësi do të depozitojë raportin përfundimtar të pestë kombëtar në sekretariatit e CBD-së dhe do të raportojë NBSAP-në të rishikuar në Konferencën e Palëve (siç përcaktohet nga CBD-ja), me një njoftim të menjëhershëm për Bankën Botërore për këtë depozitim dhe raportimin në përputhje me seksionin 4.03 të kësaj marrëveshjeje, jo më vonë se një muaj para datës së mbylljes së specifikuar në seksionin 3.03 të kësaj marrëveshjeje.

2.05 Menaxhimi financiar. a) Marrësi do të sigurojë që të mbahet një sistem i menaxhimit financiar në përputhje me dispozitat e seksionit 2.07 të kushteve standarde.

b) Marrësi do të sigurojë që të përgatiten dhe t’i dorëzohen Bankës Botërore raportet e ndërmjetme të paaudituar financiare për aktivitetet mbi bazë gjashtëmujore pas përfundimit të dyzet e pesë (45) ditëve të çdo periudhe, në një formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën Botërore.

c) Marrësi do t’i auditojë deklaratat financiare në përputhje me dispozitat e seksionit 2.07 (b) të kushteve standarde. Çdo audit i deklaratave financiare do të mbulojë secilin vit fiskal të Marrësit, gjatë të cilit janë bërë tërheqje nga llogaria e grantit. Deklaratat financiare të audituara për çdo periudhë do t’i dorëzohen Bankës Botërore jo më vonë se gjashtë muaj pas fundit të kësaj periudhe.

2.06 Prokurimi

a) Të përgjithshme. Të gjitha mallrat, shërbimet jokonsulente dhe shërbimet konsulente që kërkojnë për projektin dhe që do të financohen nga paratë e grantit, do të prokurohen në përputhje me kërkesat e parashtruara dhe të referuara në:

i) Seksioni I i “Udhëzimeve: prokurimi i mallrave, i punimeve dhe i shërbimeve jokonsulente sipas huave të IBRD-së dhe kredive dhe granteve IDA”, të janarit 2011 (udhëzimet e prokurimit), në rastin e mallrave dhe shërbimeve jokonsulente;

ii) Seksioni I dhe IV i “Udhëzimeve: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve sipas huave IBRD dhe kredive dhe granteve IDA nga Huamarrësit e Bankës Botërore” të janarit 2011 (udhëzime për konsulentët) në rastin e shërbimeve konsulente; dhe

iii) Dispozitat e këtij seksioni, si të njëjta, do të përpunohen në planin e prokurimit të përgatitur dhe të përditësuar herë pas here nga Marrësi për projektin në përputhje me paragrafin 1.18 të udhëzimeve të prokurimit dhe paragrafit 1.25 të udhëzimeve të konsulentit (plani i prokurimit).

b) Përkufizimet. Termat me germa të mëdha të përdorura në paragrafët e mëposhtëm të këtij seksioni për të përshkruar metodat e veçanta të prokurimit ose metodat e rishikimit nga Banka Botërore për kontrata të veçanta, i referohen metodës korresponduese të përshkruar në seksionet II dhe III të udhëzimeve të prokurimit ose seksioneve II, III, IV dhe V të udhëzimeve për konsulentin, si të jetë rasti.

c) Metodatat e veçanta të prokurimit të mallrave dhe të shërbimeve jokonsulente:



Metodat e mëposhtme mund të përdoren për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve jokonsulente për ato kontrata që specifikohen në planin e prokurimit: A) blerjet; dhe B) kontraktimi i drejtpërdrejtë.

d) Metodat e veçanta të prokurimit të shërbimeve konsulente. Metodat e mëposhtme mund të përdoren për prokurimin e shërbimeve të konsulentëve për ato detyra që specifikohen në planin e prokurimit: A) përzgjedhje e bazuar në kualifikimet e konsulentëve; B) përzgjedhja me burim të vetëm të firmave konsulente; C) përzgjedhja e konsulentëve individualë; dhe D) procedurat me burim të vetëm për përzgjedhjen e konsulentëve individualë.

e) Rishikimi nga Banka Botërore i vendimeve të prokurimit. Plani i prokurimeve do të parashikojë ato kontrata, të cilat do t'i nënshtrohen rishikimit paraprak të Bankës Botërore, në qoftë se është e aplikueshme. Të gjitha kontratat e tjera do t'i nënshtrohen rishikimit të mëvonshëm nga Banka Botërore.

Neni 3

Tërheqja e parave të grantit

3.01 Shpenzimet e pranueshme. a) Marrësi mund të tërheqë para nga granti në përputhje me dispozitat e: i) kushteve standarde; ii) të këtij seksioni; dhe iii) të atyre udhëzimeve shtesë që Banka Botërore mund të specifikojë me njoftim për Marrësin (duke përfshirë “udhëzimet e Bankës Botërore për disbursimin për projektet” të majit 2006, siç rishikohet herë pas here nga Banka Botërore dhe siç bëhet i aplikueshëm për këtë marrëveshje sipas këtyre udhëzimeve), për të financuar shpenzimet e pranueshme, siç parashikohet në tabelën e mëposhtme. Tabela specifikon kategoritë e shpenzimeve të pranueshme që mund të financohen nga paratë e grantit (kategoria), alokimet e shumave të grantit për çdo kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohen për shpenzimet e pranueshme në çdo kategori:

Kategoria	Shuma e grantit të flokuar (shprehur në USD)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (duke përfshirë taksat)
1) Shërbimet konsulente, mallrat, mbledhjet dhe seminarët, dhe kostot operuese	200,000	100%
6) Kostoja e menaxhimit të projektit	20,000	100%
SHUMA TOTALE	220,000	100%

b) Për qëllimet e këtij seksioni, termi: i) “mbledhjet dhe takime pune” do të thotë kostot që shoqërohen me përgatitjen dhe zhvillimin e mbledhjeve dhe takimeve të punës sipas seksionit 2.01 të kësaj marrëveshjeje, duke përfshirë udhëtimin, akomodimin dhe kostot e jetesës për pjesëmarrësit e mbledhjes dhe të takimit të punës, marrja me qira të ambienteve të mbledhjes dhe të takimit të punës dhe pajisjet, kostot e komunikimit që shoqërohen me mbledhjet dhe takimet e punës dhe përgatitja dhe riprodhimi i materialeve të mbledhjes dhe takimit të punës, dhe kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me përgatitjen dhe zbatimin e mbledhjeve dhe takimeve të punës; ii) termi “kosto operuese” do të thotë kostot operuese që kryhen për qëllimet e implementimit të projektit, duke përfshirë mirëmbajtjen e mjeteve dhe pajisjeve karburantin, marrjen me qira të zyrës, furnizimet e zyrës, utilitetet, gjëra të konsumueshme, pagesat për bankën, shpenzimet e reklamës, udhëtimi, dietat, akomodimi dhe pagat e stafit të përzgjedhur të mbështetjes, por duke përjashtuar pagat e nëpunësve dhe konsulentëve; dhe iii) termi “kosto të menaxhimit të projektit” do të thotë koston e arsyeshme që lidhen me mbikëqyrjen e projektit, që përndryshe nuk financohen sipas kategorisë 1.

3.02 Kushtet e tërheqjes. Pavarësisht dispozitave të seksionit 3.01 të kësaj marrëveshjeje, asnjë tërheqje nuk do të bëhet për pagesat e bëra përpara datës së kundërfirmosjes së kësaj marrëveshjeje nga Marrësi.

3.03 Periudha e tërheqjes. Data mbyllëse, që përmendet në seksionin 3.06 (c) të kushteve standarde, është tridhjetë muaj pas datës së kundërfirmosjes së kësaj marrëveshjeje nga Marrësi.

Neni 4

Përfaqësuesi i Marrësit; adresat

4.01 Përfaqësuesi i Marrësit. Përfaqësuesi i Marrësit, që përmendet në seksionin 7.02 të kushteve standarde, është pika fokale operationale GEF e tij.

4.02 Adresa e Marrësit. Adresa e Marrësit, që përmendet në seksionin 7.01 të kushteve standarde, është:

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave

Rruga e Durrësit, nr. 27

Tiranë, Shqipëri

Tel: + 355 4227 0624

Faks: 011 355 4227 0624

4.03 Adresa e Bankës Botërore. Adresa e Bankës Botërore, e përmendur në seksionin 7.01 të kushteve standarde është:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim

c/o CEO/Chairperson, Global Environment Facility

1818 H Street, N.W.

Washington. D.C. 20443

Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Kablllo:

Teleks:

Faks:

INTBAFRAD

248423 (MCI) ose 1-202-477-6391

Washington D.C.

64145 (MCI)

VENDIM

Nr. 830, datë 21.11.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 484, DATË 23.6.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË BORDIT TË MENAXHIMIT PËR
AUTORITETIN RRUGOR SHQIPTAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8, pikat 2 shkronja “ç”, e 5, të ligjit nr. 10 164, datë 15.10.2009 “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në shkronjën “c” të pikës 1 të vendimit nr. 484, datë 23.6.2010 të Këshillit të Ministrave, në përbërje të bordit të menaxhimit për Autoritetin Rrugor Shqiptar, “z. Etion Kapedani....” zëvendësohet me “z. Isuf Çelaj...”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM

Nr. 831, datë 21.11.2012

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË Z. ALBERT KRYEMADHI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në zërin “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 1 658 950 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve të kurimit të z. Albert Kryemadhi.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
3. PAGESA të bëhet me paraqitjen e faturave për shërbimin e ofruar.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 833, datë 21.11.2012

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË KONTRIBUTIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EUROPËS (CEBD), PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “REHABILITIMI I SPITALIT RAJONAL TË SHKODRËS, FAZA E TRETË”, ME NJË GRANT 50 (PESËDHJETË) MIJË EURO

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së kontributit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEBD), për financimin e projektit “Rehabilitimi i spitalit rajonal të Shkodrës, faza e tretë”, me një grant prej 50 (pesëdhjetë) mijë eurosh, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE KONTRIBUTI
NDËRMJET KËSHILLIT TË BANKËS EUROPIANE PËR ZHVILLIM DHE REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Këshilli i Bankës Europiane për Zhvillim, Organizata Ndërkombëtare, Paris (më poshtë i quajtur KBE), nga njëra anë, dhe Republika e Shqipërisë (Përfituesi), i përfaqësuar nga Ministria e Financave (më poshtë e quajtur MF), si huamarrës i KBE-së për financimin e pjesëm të projektit F/P 1385 shtojca 4 “Rehabilitimi i Spitalit Rajonal të Shkodrës - faza e tretë”, të aprovuar nga Këshilli Administrativ i KEB-it më 14 nëntor 2007;

Sipas një marrëveshjeje të nënshkruar më 19 prill 2004 dhe marrëveshjeve të saj shtesë, KEB-i dhe Mbretëria e Norvegjisë kanë rënë dakord që të krijojnë një llogari besimi në KEB për të financuar aktivitete të projekteve të ndryshme, që mbështesin reformat sociale dhe ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor, me objektiv themelor dhënien e ndihmës, në mënyrë që ato të përgatiten për anëtarësimin përfundimtar në BE;

Duke marrë në konsideratë se KEB-i, nëpërmjet llogarisë së besimit në Norvegji, dëshiron t’i japë një kontribut Përfituesit, për t’i siguruar asistencë teknike Ministrisë së Shëndetësisë (më poshtë MSH) për zbatimin e projektit F/P 1385 shtojca 4 “Rehabilitimi i Spitalit Rajonal të Shkodrës - faza e tretë” (më poshtë i quajtur “projekti”), siç është përmbledhur në shtojcën A të kësaj marrëveshjeje;

Duke marrë në konsideratë se KEB-i dhe Përfituesi nënshkruan një marrëveshje kuadër të kredisë (më poshtë MSK) për projektin F/P 1385 shtojca 4 “Rehabilitimi i Spitalit Rajonal të Shkodrës - faza e tretë” në shumën prej 6 000 000 euro dhe MSK-ja u ratifikua nga Parlamenti Shqiptar më 9 tetor 2008.

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje, ndërmjet KEB-it dhe Përfituesit, është përcaktimi i termave dhe kushteve që lidhen me transferimin dhe menaxhimin e këtij granti për projektin;

Rrjedhimisht, KEB-i dhe Përfituesi bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Granti

1.1 KEB-i, sipas mënyrës së referuar në paragrafin 1.2 të këtij neni, vendos në dispozicion të MF-së një shumë prej 50 000 eurosh, të cilat i korrespondojnë grantit, më poshtë i quajtur “grant” për t’u paguar me një kësht të vetëm, siç përshkruhet në shtojcën A.

1.2 KEB-i do të depozitojë shumën e grantit në një llogari të veçantë të projektit të hapur në Bankën Qendrore të Shqipërisë nga MF-ja.

MF-ja do të kalojë të gjitha të ardhurat nga kontributi KEB nëpërmjet një llogarie të veçantë të hapur në një bankë tregtare nga MF-ja dhe të krijuar vetëm për këtë projekt. MSH-ja nëpërmjet NJZP-së (shihni 4.2) autorizohet që të kryejë veprime në llogarinë e veçantë. Të gjitha transaksionet autorizohen, regjistrohen dhe raportohen nga MSH-ja nëpërmjet NJZP-së.

1.3 Granti paguhet në euro. Të gjitha llogaritë dhe deklaratat financiare shprehen në euro.

Neni 2

Kushtet për përdorimin e grantit

2.1 Granti i vënë në dispozicion nga KEB-i do të përdoret ekskluzivisht për qëllimin për të cilin është synuar (shtojca A).

2.2 Çdo ndryshim i rëndësishëm në projekt i nënshtrohet aprovimit me shkrim nga KEB-i përpara se këto ndryshime të përfshihen në projekt. Nëse ndodh ndonjë ndryshim që, sipas opinionit të KEB-it, mund të dëmtojë ndikimin e projektit, KEB-i rezervon të drejtën për të pezulluar, anuluar ose kërkuar shlyerje të menjëhershme të grantit.



2.3 MF-ja nëpërmjet MSH-së ushtron të gjithë kujdesin dhe vëmendjen e duhur dhe shfrytëzon të gjitha mjetet që përdoren zakonisht, në veçanti mjetet financiare, teknike, sociale dhe menaxheriale, të cilat do të jenë të nevojshme për administrimin e duhur të grantit.

2.4 Çdo balancë që do të mbetet e pashpenuar me përfundimin e projektit sipas kësaj marrëveshjeje, përfshirë çdo të ardhur interesi që i atribuohet grantit, do t'i kthehet KEB-it në euro, nëse palët nuk bien dakord ndryshe.

2.5 MF-ja nëpërmjet MSH-së garanton transparencë për Mbretërinë e Norvegjisë dhe KEB-in, duke informuar përfituesit e projektit për pjesëmarrjen e KEB-it nëpërmjet llogarisë së besimit në Norvegji në financimin e projektit.

Neni 3

Përgjegjësia për projektin

3.1 Përfituesi cakton MSH-në për menaxhimin, zbatimin, monitorimin dhe raportimin e projektit. Megjithatë, përgjegjësia për të vepruar në përputhje me të gjitha detyrimet sipas marrëveshjes i mbetet Përfituesit.

3.2 MSH-ja do të shfrytëzojë të njëjtën Njësi për Zbatimin e Projektit (NJZP), që është krijuar brenda strukturës së saj për projektin F/P 1385 shtojca 4 “Rehabilitimi i Spitalit të Shkodrës, faza e tretë”. NJZP-ja është ekipi i MSH-së në ngarkim të zbatimit të përditshëm, menaxhimit fizik dhe financiar dhe vijueshmërisë së projektit.

3.3 MSH-ja nëpërmjet NJZP-së do të ketë përgjegjësinë për fondet e marra nga KEB-i, zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit dhe do të mbajë të informuar KEB-in dhe MF-në mbi progresin e projektit, duke i dhënë KEB-it raportet dhe siç përcaktohet më tej në nenin 6 më poshtë.

Neni 4

Zbatimi i projektit

4.1 Grantidotëmbulojnë pjesë të kostove të mbikëqyrjes së projektit, siç përshkruhet në shtojcën A. KEB-i nuk merr përsipër të mbulojë asnjë shpenzim që tejkalon shumën e grantit prej 50 000 eurosh.

4.2 MF-ja do të garantojë se MSH/NJZP do ta përdorin grantin e KEB-it në përputhje me procedurat e projektit F/P 1385 shtojca 4, duke përfshirë tenderimin, prokurimin, monitorimin e punimeve.

4.3 Nëse priten ose ndodhin rritje të paparashikuara shpenzimesh apo detyrimesh financiare (qoftë për shkak të faktorëve të inflacionit, luhatjeve në kurset e këmbimit apo shumave rezervë të paparashikuara), MF-ja do të garantojë se MSH/NJZP do ta informojë në kohë siç duhet KEB-in në lidhje me rritjet.

Neni 5

Mbajtja e llogarive

5.1 MSH-ja, nëpërmjet NJZP-së, do të bëjë regjistrime të llogarive që kanë lidhje me projektin, të cilat duhet të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe të tregojnë në çdo kohë gjendjen e progresit të projektit dhe do të regjistrojë të gjitha veprimet e kryera me ndihmën e këtij granti. Granti i KEB-it i nënshtrohet procedurave të brendshme dhe të jashtme të auditimit, të përcaktuara në rregulloret financiare, rregullat dhe direktivat e zbatueshme në MSH dhe në projektin F/P 1385 shtojca 4.

Neni 6 Monitorimi dhe raportet

6.1 MF-ja do të garantojë se raportimet e MSH/NJZP mbi shpenzimet e kryera do të jenë të shprehura në euro ose nëse pagesat do të bëhen në ndonjë monedhë tjetër, duke i konvertuar shumat përkatëse të paguara në euro sipas kursit ekzistues të këmbimit ndërbankar në ditën e pagesës së kontraktorit në monedhën jo euro.

6.2 MF-ja do të garantojë që MSH/NJZP do t'i japë KEB-it raporte të përgatitura në përputhje me procedurat ndërkombëtare të mbajtjes së llogarive dhe raportimit.

6.3 MF-ja do të garantojë se MSH/NJZP do të paraqesin te KEB-i kopje të të gjitha raporteve nga kontraktori mbikëqyrës gjatë periudhës përkatëse të zbatimit dhe një raport përfundimi te KEB-i dhe MF-ja tridhjetë (30) ditë pas përfundimit të aktiviteteve të mbështetura nga ky grant. Raporti i përfundimit do të përfshijë një vlerësim të aktiviteteve dhe një raport financiar. Ky raport përfundimi do të jetë i pranueshëm për KEB-in dhe MF-në.

6.4 MF-ja do të garantojë se MSH/NJZP do t'u japë përfaqësuesve të KEB-it akses në dokumentacionin e projektit, përfshirë mbajtjen e llogarive që janë të lidhura me projektin.

Neni 7 Njoftimi

7.1 Çdo njoftim që do t'i jepet secilës prej palëve në lidhje me këtë marrëveshje do të bëhet ose do të dërgohet në mënyrë efikase me shkresë ose faks te palët e adresuara më poshtë. Adresa e secilës prej palëve mund të ndryshohet me njoftime, sipas mënyrës së përcaktuar në këtë dispozitë.

7.2 Çdo njoftim për KEB-in do të adresohet në:

Director General for Loans
Council of Europe Development Bank
55, Avenue Kleber
75016 Paris, France
Faks: 33 1 47 55 37 52

Çdo njoftim për MF-në do të adresohet në:

Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" nr. 1, Tirana, Albania
Në vëmendje të: Ministrisë të Financave
Faks: +(355 4) 22 84 94

Neni 8 Amendamentet

8.1 Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me amendamente zyrtare nga KEB-i dhe MF-ja, ku secila prej tyre do të japë vlerësim të plotë për amendimin e çdo propozimi.

Neni 9 Konfliktet

9.1 Konfliktet ndërmjet palëve të kësaj marrëveshjeje i nënshtrohen arbitrazhit sipas kushteve të përcaktuara në kapitullin 4 të rregullores për kredinë KEB.



Neni 10

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e marrëveshjes

10.1 Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi pas njoftimit, nënshkrimit nga palët dhe pas përfundimit të procedurës përkatëse ligjore të Republikës së Shqipërisë.

10.2 Marrëveshja nuk do të jetë më në fuqi tridhjetë ditë pasi njëra nga palët të ketë dhënë njoftimin me shkrim të palët e tjera për vendimin e saj për t'i dhënë fund marrëveshjes për arsye të bazuara.

10.3 Marrëveshja nuk do të jetë më në fuqi në rastet e mëposhtme:

- Pagimi i grantit të plotë nga ana e KEB-it për Përfituesin;
- Shfrytëzimi i plotë i grantit ose rikthimi eventual të KEB-i nga Përfituesi të çdo balance të mbetur, e pashpenzuar në kohën e përfundimit të projektit;
- Paraqitja e një raportit përfundim nga MSH/NJZP të KEB-i, si dhe pranimi nga kjo e fundit dhe MF-ja të raportit të përfundimit, siç përcaktohet në pikën 6.3 më lart.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit, të autorizuar sipas rregullave, kanë nënshkruar këtë marrëveshje në gjuhën angleze në dy kopje origjinale.

Nënshkruar në _____

Më (data) _____

Nënshkruar në _____

Më (data) _____

Për Këshillin e Bankës Europiane për Zhvillim

Emri: _____

Titulli: _____

Për Republikën e Shqipërisë
Ministria e Financave

Emri: _____

Titulli: Ministër _____

**SHTOJCA A
SINTEZA E PROJEKTIT**

Projekti	Asistencë teknike për zgjatjen e kontratës së mbikëqyrjes në lidhje me projektin F/P 1385 shtojca 4 “Rehabilitimi i Spitalit Rajonal të Shkodrës - faza e tretë”
Shteti	Shqipëri
Agjencia e zbatimit	MSH-ja nëpërmjet NJZP-së
Përfituesit	Ministria e Shëndetësisë
Vlera e grantit	50 000 euro
Periudha e zbatimit	1 qershor deri më 31 tetor 2012
Shpenzimet e planifikuara	Fondet e grantit do të përdoren për të zgjatur kontratën ekzistuese të mbikëqyrjes me TopConsult, Bon, Gjermani.
Ndikimet sociale	Spitali Rajonal i Shkodrës është qendra më e rëndësishme për kujdesin shëndetësor për pacientët ambulatorë dhe spitalorë në pjesën veriore të vendit. Sapo të përfundojë faza e tretë, spitali do të ketë një nivel të ri të shërbimeve shëndetësore, që do të përfshijnë koordinimin ndërmjet shërbimeve të specialitetit; projektin në përbushje të nevojave personale të pacientit; fleksibilitetin për ndryshime të mundshme; standarde moderne të kujdesit; të gjitha këto për interesin më të mirë të pacientëve ambulatorë dhe spitalorë të rajonit të Shkodrës.
Procedurat e pagesës	Me një këst të vetëm prej €50 000, pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes së kontributit.

VENDIM
Nr. 834, datë 21.11.2012

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
BASHKISË BERAT TË QARKUT TË BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Berat të qarkut të Beratit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 265 (dyqind e gjashtëdhjetë e pesë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 2948 (dy mijë e nëntëqind e dyzet e tetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Berat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Berat

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-29/1	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
36-37,39-42/3	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
1188-1211	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
44-52,1224	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile	Në pronësi
53-55	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shërbimit funeral	Në pronësi
56-67,1295-1296	Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike). Transferohet prona me nr. 1296 me Z/K 8502, nr.pasurie 27/251 (zyrat e Drejtorisë së Parkut të Autobusëve) me sip.trualli 400 m ²	Në pronësi
1153-1157,1225-1229,1231-1232	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
68-1118	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
1133,1149	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e administratës	Në pronësi
2896-2899	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
1299-2686,2690-2895/1	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
1240-1245	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shërbimit social	Në pronësi



VENDIM
Nr. 836, datë 21.11.2012

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
KOMUNËS LENIE TË QARKUT TË ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Lenie të qarkut të Elbasanit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 101 (njëqind e një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 702 (shtatëqind e dy).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Lenie për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Lenie

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-87,693	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
88-122	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
123	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shërbimit social	Në pronësi
124-127	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
128	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
129-132	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore dhe sportive	Në pronësi
133-165	Varreza publike	Në pronësi
467,469-471,695,696	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
468,697-702	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
472-607,693	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi

VENDIM
Nr. 839, datë 21.11.2012

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË Z. MYZAFER ZAIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në zërin “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 600 000 (gjashtëqind mijë) lekësh, për përballoimin e shpenzimeve të kurimit të z. Myzafer Zaimi.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave për shërbimin e ofruar.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 842, datë 14.11.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 234, DATË 6.3.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT ELEKTRIK 400/220/110 KV NË KASHAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 234, datë 6.3.2009 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:
“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen totale të shpronësimit prej 104 500 (njëqind e katër mijë e pesëqind) m², vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 339 507 924 (treqind e tridhjetë e nëntë milionë e pesëqind e shtatë mijë e nëntëqind e njëzet e katër) lekësh.”.
2. Në tabelën e të shpronësuarve, që i bashkëlidhet vendimit, prona me nr. 32/3, me sipërfaqe 4 500 (katër mijë e pesëqind) m² tokë, në emër të Veiz Jashar Dema, ndahet në 2 (dy) pjesë:
 - Prona me nr. 32/30, me sipërfaqe 2000 (dy mijë) m² bëhet në emër të Haxhi Dema;
 - Prona me nr. 32/31, me sipërfaqe 2000 (dy mijë) m² bëhet në emër të Nezir Dema.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



Nr.	Objekti	Shpronësim defenitiv											Vlera totale e kompensimit në lekë	Adresa e pronarit	Dokumentacioni
		Emri	Atësia	Mbledhëri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Sasia, shpronësim defenitiv m ²	Cmimi shitje ZRPP lekë/m ²	Vlera e kompensimit	Lloji i kulturës	Vlera në lekë për kulturën			
1	Nst.400kV	Haxhi	Jashar	Dema	arë	2105	32/30	2000	2500	5,000,000	jonxhë	20,000	5,022,222	Kashar	Me certifikatë pronësie
2	Nst.400kV	Nezir	Jashar	Dema	arë	2105	32/31	2000	2500	5,000,000	jonxhë	20,000	5,022,222	Kashar	Me certifikatë pronësie

VENDIM
Nr. 843, datë 2.11.2012

PËR KRIJIMIN E SHTËPISË BOTUESE TË TEKSTEVE MËSIMORE (BOTEM)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e personit juridik publik “Shtëpia Botuese e Teksteve Mësimore (BOTEM)”, si institucion buxhetor në varësi të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

2. Misioni i Shtëpisë Botuese të Teksteve Mësimore është botimi, shpërndarja dhe shitja e teksteve mësimore të arsimit profesional, teksteve të pakicave kombëtare, diasporës, teksteve me tirazh të ulët në sistemin arsimor parauniversitar dhe i materialeve të tjera ndihmëse.

3. Detyrat kryesore të BOTEM-ës janë:

- a) Botimi dhe shpërndarja e teksteve të lëndëve profesionale për shkollat e arsimit profesional;
- b) Botimi dhe shpërndarja e teksteve në gjuhën amtare dhe teksteve të veçanta historike e kulturore për shkollat e pakicave kombëtare;
- c) Botimi i moduleve profesionale dhe teksteve të veçanta të kurrikulës me zgjedhje në shkollat e arsimit parauniversitar;
- ç) Botimi i teksteve të veçanta, që hyjnë në procesin mësimor-edukativ në zbatim të marrëveshjeve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës me subjekte të huaja;
- d) Botimi i teksteve të veçanta për diasporën.

4. Shtypja e teksteve të përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi, realizohet nga Shtypshkronja e Letrave me Vlerë sh.a., me kapital shtetëror, në varësi të Ministrisë së Financave.

5. Për secilin tekst mësimor, Shtëpia Botuese e Teksteve Mësimore (BOTEM) formon grupet e autorëve, komisionet e posaçme për diskutimin dhe miratimin e teksteve, si dhe organizon fillimin e procedurës së botimit. Anëtarët e grupeve dhe komisioneve paguhen sipas akteve nënligjore në fuqi.

6. Statuti dhe rregullorja e Shtëpisë Botuese të Teksteve Mësimore miratohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

7. Procedurat e botimit, shpërndarjes dhe shitjes së teksteve të arsimit profesional, teksteve në gjuhën amtare dhe teksteve të veçanta historike e kulturore për shkollat e pakicave kombëtare, si edhe të teksteve të veçanta për diasporën, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

8. Çmimi i shitjes së teksteve, të përcaktuara në pikën 6 të këtij vendimi, përcaktohet në bazë të metodologjisë së parashikuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

9. Drejtuesi i Shtëpisë Botuese të Teksteve Mësimore emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin, lirimimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose Ministrit”.

10. Struktura dhe organika e BOTEM-ës miratohen me urdhër të Kryeministrit.

11. Numri i punonjësve të BOTEM-ës të jetë i përfshirë në numrin e përgjithshëm të punonjësve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

12. Shtëpia Botuese e Teksteve Mësimore (BOTEM) është institucion buxhetor, që financohet nga Buxheti i Shtetit, i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Të gjitha të ardhurat e krijuara nga aktiviteti i BOTEM-ës derdhen në Buxhetin e Shtetit.

13. Buxheti i planifikuar për Shtëpinë Botuese të Librit Universitar, të gjitha asetet dhe detyrimet e saj i kalojnë Shtëpisë Botuese të Teksteve Mësimore (BOTEM).

14. Vendimi nr. 437, datë 20.12.1986 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Shtëpisë Botuese të Librit Universitar”, i ndryshuar, shfuqizohet.

15. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 844, datë 21.11.2012

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION TË
HIDROCENTRALEVE “VËRMIK 1, 2 DHE 3” DHE MIRATIMIN E BONUSIT NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 3, dhe 23, pika 3b të ligjit, nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion të hidrocentraleve “Vërmik 1, 2 dhe 3” të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2 pikëve për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë “SOPI” sh.p.k., për dhënie me koncesion të këtyre hidrocentraleve.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentraleve “Vërmik 1, 2 dhe 3”, të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të pellgut ujëmbledhës, i cili përfshihet në skemën e shfrytëzimit të këtyre hidrocentraleve.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 845, datë 21.11.2012

**PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 428, DATË 9.6.2010 TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE “PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE, QË
PRIVATIZOHET APO TRANSFORMOHET DHE PËR PROCEDURËN E SHITJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2 të aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008 “Për privatizimin dhe dhënie në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të



ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, me propozimin e Zëvendëskryeministrit e Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 428, datë 9.6.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1.1 Në kreun II bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në fund të pikës 6 shtohen fjalët “... Tejkalimi i këtij afati ngarkon këtë institucion me përgjegjësi ligjore.”.

b) Pika 7 ndryshohet si më poshtë vijon:

“7. Pas marrjes së genplanit të konfirmuar të objektit nga prefektura, Dega e Shoqërive Publike i kërkon Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të dhëna për pronësinë e objektit dhe truallit që privatizohet, hartën treguese, vërtetimin hipotekor apo certifikatën e pronësisë, nëse ka. Kërkesën e mësipërme, Dega e Shoqërive Publike e shoqëron me një kopje të genplanit, të konfirmuar nga prefektura e qarkut përkatës. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës, i dërgon Degës së Shoqërive Publike të dhënat që disponon për pronën që privatizohet, hartën treguese, vërtetimin hipotekor apo certifikatën e pronësisë, nëse ka të tilla.

Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme mban përgjegjësi ligjore për të dhënat e konfirmuara, si dhe për tejkalimin e afatit ligjor, të përcaktuar në këtë vendim.”.

c) Në fund të pikës 10 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Agjencia e Kthimit dhe e Kompensimit të Pronave mban përgjegjësi ligjore për çmimin e truallit të konfirmuar me shkresën përkatëse, si dhe për tejkalimin e afatit ligjor të përcaktuar në këtë vendim.”.

1.2 Në kreun III bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Pas paragrafit të parë të shkronjës “a” të pikës 2, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Për rastet kur konfirmohet se trualli i objektit apo i ndërmarrjes që privatizohet (nën objekt) është truall privat i regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në bazë të vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave apo i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe i konfirmuar pranë zyrës vendore përkatëse të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, atëherë subjektit të shpronësuar i lind e drejta e parablerjes së objektit.”.

b) Në paragrafin e tretë të shkronjës “a” të pikës 2, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Për rastet kur komisioni i ngritur nga Drejtori i Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike ka vështirësi në përditësimin e dokumentacionit hartografik (planvendosja e pronës së ish-pronarëve, genplani i objektit në proces privatizimi dhe harta treguese e lëshuar nga zyra vendore përkatëse e regjistrimit të pasurive të paluajtshme) për truallin, sipërfaqe nën objekt dhe funksionale të objektit apo ndërmarrjes në proces privatizimi, sipas pikës 12 të këtij vendimi, atëherë Drejtorja e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike do të angazhojë ekspertë të licencuar të fushës së hartografisë. Në përfundim të verifikimit, eksperti i licencuar do të dorëzojë një raport me shkrim të shoqëruar me dokumentacionin hartografik për rezultatin e verifikimit. Eksperti mban përgjegjësi ligjore për përfundimet që do të paraqesë në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, nëpërmjet raportit dhe dokumentacionit teknik.

Shpenzimet për kryerjen e këtyre verifikimeve do të mbulohen nga vetë pala e interesuar për blerjen e objektit apo ndërmarrjes me aktmarrëveshje ndërmjet tyre, një kopje e së cilës depozitohet edhe në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike.”.

c) Pas shkronjës “ç” të pikës 11, shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) Deklaratë noteriale, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar, që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar

kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.”.

d) Pikat 28, 31, 33 dhe 34 ndryshohen si më poshtë vijon:

“28. Kontratat e nënshkruara nga përfaqësuesi i ish-Agjencisë Kombëtare të Privatizimit dhe i degëve të saj në rrethe, për objektet apo ndërmarrjet e privatizuara në vite me përfaqësuesin e ndërmarrjes dhe blerësit të parë të objektit apo ndërmarrjes, por jo sipas mënyrës së kërkuar nga ligji (para noterit), për rastet kur aktualisht ndërmarrja nuk ekziston, bëhen nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave, dhe blerësit, me kushtin që për këto objekte apo ndërmarrje të mos jenë bërë regjistrime dhe transkriptime pranë zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, konfirmuar nga kjo e fundit dhe kur dokumentacioni, që ndodhet në arkivat e kësaj drejtorie, është i rregullt.

Kur ndërmarrja ekziston, bëhet nga drejtori i ndërmarrjes dhe blerësi, para noterit.

...

31. Për objektet ndërtimore, të cilat kanë kaluar të gjitha fazat e shitjes dhe nuk janë shitur, dokumentacioni i vlerësimit të objektit kthehet nga Ministria e Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, brenda 8 (tetë) muajve nga zhvillimi i fazës së fundit të shitjes. Në rast se gjatë kësaj periudhe ka kërkesa me shkrim për blerje të objektit, atëherë përsëritet procedura e fazës së fundit të shitjes.

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës e dërgon dokumentacionin e kthyer në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për t’u përdorur si fond i kompensimit fizik.

Për makineritë, pajisjet, mjetet e xhiros, inventarin ekonomik, të cilat nuk janë shitur edhe pasi janë zbatuar të gjitha fazat e shitjes, veprohet sipas ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 të Këshillit të Ministrave “Për menaxhimin e aktiveve të njësisve të sektorit publik”, në zbatim të tij.

...

33. Pasuritë shtetërore, të dhëna me kontratë qiraje ose enfiteozë, me sipërfaqe mbi 500 (pesëqind) m², i shiten në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave, kontraktuesit, në rast se vlera e investimit të kryer prej tij është mbi 150% e vlerës së truallit, si dhe kur subjekti nuk ka detyrime ndaj shtetit. Me plotësimin e këtij kushti, ministri përgjegjës për ekonominë urdhëron vazhdimin e procedurave për privatizimin e objektit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

Për rastet kur objekti ka pronarë truall, vlera e truallit, sipas përcaktimeve të bëra në dosjen e privatizimit, i kalon pronarit për kompensim.

34. Kur ministri përgjegjës për ekonominë urdhëron përfshirjen në procedurë privatizimi të ndërmarrjes, shoqërisë dhe institucionit që ka dhënë mjedise me qira ose enfiteozë, me sipërfaqe mbi 500 (pesëqind) m², apo urdhëron përfshirjen në procedurë privatizimi të objektit të dhënë me qira, mbi 500 (pesëqind) m², përpara përfundimit të kontratës së qirasë, në publikimin për shitjen e tyre njoftohet ekzistenca e kontratave të qirasë ose enfiteozës, të lidhura në këtë objekt.

Blerësi është i detyruar të respektojë kushtet e kontratës deri në përfundimin e afatit të saj.”.

1.3 Kudo në vendim, pas fjalëve “... ekspert vlerësues i licencuar ...” shtohen fjalët “... ose i certifikuar ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, prefekti i qarkut dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 846, datë 21.11.2012

**PËR CAKTIMIN E FUNKSIONEVE, TË PËRGJEGJËSIVE DHE TË MARRËDHËNIEVE
NDËRMJET AUTORITETEVE E STRUKTURAVE TË MENAXHIMIT TË DECENTRALIZUAR
TË ASISTENCËS SË BASHKIMIT EUROPIAN, NË KUADËR TË INSTRUMENTIT TË
PARAZGJERIMIT (IPA), PËR ZHVILLIMIN RURAL, KOMPONENTI V¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6 e 8 të ligjit nr. 9840, datë 10.12.2007 “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane, për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA)”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qëllimi i vendimit

Ky vendim përcakton funksionet, përgjegjësitë dhe krijon marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet autoriteteve dhe strukturave për menaxhimin plotësisht të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Europian, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Parazgjerimit (IPA), për zhvillimin rural, komponenti V (në vijim IPARD).

2. Autoritetet dhe strukturat menaxhuese

a) Autoritetet e mëposhtme të menaxhimit plotësisht të decentralizuar krijohen në Shqipëri:

i) Koordinatori Kombëtar i IPA-s (në vijim KKIPA/NIPAC);

ii) Zyrtari Përgjegjës Akreditues (në vijim ZPA/CAO);

iii) Zyrtari Kombëtar Autorizues (në vijim ZKA/NAO).

b) Strukturat e menaxhimit plotësisht të decentralizuar për IPA-n do të jenë:

i) Fondi Kombëtar;

ii) Zyra e ZKA-së/NAO-së;

iii) Struktura operative për zbatimin e komponentit V, e përbërë nga Autoriteti Menaxhues (MA) dhe Agjencia e Pagesave IPARD (më tej: Agjencia e IPARD-së), në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;

iv) Autoriteti i Auditit.

3. Koordinatori Kombëtar i IPA-s (KKIPA/NIPAC)

a) Koordinatori Kombëtar i IPA-s (në vijim KKIPA/NIPAC) është ministri përgjegjës për integrimin europian.

b) KKIPA/NIPAC është autoriteti i menaxhimit të decentralizuar, i cili, në zbatim të pikës 2 të aneksit A të marrëveshjes kuadër, është përgjegjës:

i) të sigurojë bashkërendimin e përgjithshëm të asistencës së IPA-s, komponenti V;

ii) të sigurojë partneritet ndërmjet Komisionit Europian dhe Republikës së Shqipërisë, si dhe të sigurojë që fondet e IPA-s janë përdorur në mënyrë efektive për zbatimin e përparësive, në kuadër të integritetit europian;

iii) të sigurojë koherencë dhe bashkërendim për të gjitha programet e IPA-s.

c) KKIPA/NIPAC, brenda kompetencave të veta dhe duke u asistuar nga zyra e KKIPA-së/NIPAC-së, do të ushtrojë këto detyra:

¹ Në përputhje me EU acquis, ID celex-32007R0718, Commission Regulation (EC) No 718/2007, of 12 June 2007, implementing Council Regulation (EC) No 1085/2006 establishing an instrument for pre-accession assistance (IPA).

i) monitorimin, në nivel programi, të komponentit V të IPA-s; dhe
ii) përgatitjen e raporteve vjetore e përfundimtare për zbatimin e IPA-s, të cilat duhet t'i dorëzojë te Komisioni European dhe te ZKA-ja/NAO-ja, në përputhje me nenin 38 të marrëveshjes kuadër.

ç) Ministri përgjegjës për integrimin european cakton, me urdhër të brendshëm, si strukturë përgjegjëse në Ministrinë e Integritimit, zyrën e KKIPA-së/NIPAC-së, e cila do të veprojë si sekretariat i KKIPA/NIPAC, në mbështetje të ushtrimit e roleve dhe të funksioneve të tij/saj.

4. Zyrtari përgjegjës akreditues (ZPA/CAO)

a) Zyrtari përgjegjës akreditues (në vijim ZPA/CAO) është Ministri i Financave.

b) ZPA-ja/CAO-ja është autoritet i menaxhimit plotësisht të decentralizuar, përgjegjës për dhënien e akreditimit ZKA-së/NAO-së dhe strukturave në mbështetje të tij (zyrës së ZKA-së/NAO-së dhe Fondit Kombëtar) për menaxhim plotësisht të decentralizuar të komponentëve të IPA-s, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të aneksit A të marrëveshjes kuadër.

c) ZPA-ja/CAO-ja, nëpërmjet auditimeve të pavarura, kontrollon nëse janë përmbushur kriteret e akreditimit për zyrtarin kombëtar autorizues, Fondin Kombëtar dhe zyrën NAO, siç përcaktohet në shkronjën "c" të pikës 1 të aneksit A të marrëveshjes kuadër.

ç) ZPA-ja/CAO-ja, pas akreditimi të ZKA-së/NAO-së, Fondit Kombëtar dhe zyrës së ZKA-së/NAO-së është përgjegjës për monitorimin, pezullimin apo tërheqjen e akreditimit të ZKA-së/NAO-së, Fondit Kombëtar dhe zyrës së ZKA-së/NAO-së, si dhe për informimin e Komisionit European, në përputhje me shkronjën "b" të pikës 1 të aneksit A të marrëveshjes kuadër.

d) ZPA-ja/CAO-ja, pas akreditimit dhe dhënies së kompetencave menaxhuese, i paraqet Komisionit European të gjitha ndryshimet e propozuara për mënyrën e pagesës dhe ato në sistemin e menaxhimit e kontrollit dhe kopje të autoritetit të auditit për kontroll dhe miratim përpara zbatimit të tyre.

dh) ZPA-ja/CAO-ja organizon takime dhe konsultime të rregullta me autoritetin e auditit, duke siguruar funksionimin e duhur të menaxhimit të decentralizuar të komponentëve të IPA-s.

e) ZPA-ja/CAO-ja miraton manualin e brendshëm të procedurave, të përgatitur nga Ministria e Financave për funksionimin e tij.

ë) ZPA-ja/CAO-ja konfirmon manualin e brendshëm të procedurave për zyrtarin kombëtar autorizues dhe manualin e brendshëm të procedurave për Fondin Kombëtar, të përgatitur nga zyra e ZKA-së/NAO-së dhe Fondi Kombëtar.

5. Zyrtari kombëtar autorizues (ZKA/NAO)

a) Zyrtari kombëtar autorizues (në vijim ZKA/NAO) është një zyrtar i lartë në Ministrinë e Financave, i cili emërohet nga ZPA-ja/CAO-ja.

b) ZKA-ja/NAO-ja është autoritet i menaxhimit plotësisht të decentralizuar, që drejton veprimet e Fondit Kombëtar, të cilit i është besuar përgjegjësia totale e menaxhimit financiar të fondeve IPA të BE-së.

c) Në përputhje me nenin 4 të aneksit A të marrëveshjes kuadër, ZKA-ja/NAO-ja është përgjegjës për ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve të ekzekutuara brenda menaxhimit të decentralizuar, si dhe për funksionimin efektiv të sistemeve të menaxhimit e të kontrollit në përputhje me IPA-n.

ç) ZKA-ja/NAO-ja, në kryerjen e funksioneve të tij sipas nenit 4 të aneksit A të marrëveshjes kuadër, përdor kapacitetet e Fondit Kombëtar për menaxhimin financiar dhe të zyrës së ZKA-së/NAO-s në Ministrinë e Financave për funksionimin efektiv të sistemeve të menaxhimit e të kontrollit.

d) ZKA-ja/NAO-ja njofton Komisionin European për çdo zëvendësim të personit (ose personave) që kryejnë këtë funksion.

dh) ZKA-ja/NAO-ja është përgjegjës për dhënien e akreditimit strukturës operative për zbatimin e komponentëve të IPA-s dhe njofton Komisionin European në përputhje me nenin 11 të marrëveshjes kuadër. ZKA-ja/NAO-ja i jep akreditimin strukturës operative pasi sigurohet, bazuar në një opinion auditit të pavarur, se janë plotësuar kërkesat e përshkruara në nenin 9 të marrëveshjes kuadër.

e) ZKA-ja/NAO-ja, pas akreditimit të strukturës operative, të përmendur në shkronjën "f", është përgjegjës për monitorimin, pezullimin apo tërheqjen e akreditimit të strukturës operative, si dhe për



njoftimin e ZPA-së/CAO-së dhe Komisionit European, në përputhje me nenin 11 të marrëveshjes kuadër.

ë) ZKA-ja/NAO-ja do të monitorojë funksionimin e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit brenda strukturës operative.

f) Në rast se ZKA-ja/NAO-ja zbulon dobësi në sistemet e menaxhimit e të kontrollit, njofton drejtuesit e organeve që përbëjnë strukturën operative dhe jep rekomandimet për marrjen e masave të duhura korrigjuese. Në rast se drejtuesit e organeve të strukturës operative, nuk i zbatojnë masat e rekomanduara, ZKA-ja/NAO-ja njofton ministrin e tyre përgjegjës.

g) ZKA-ja/NAO-ja mund ta tërheqë akreditimin e strukturës operative, nëse strukturat kompetente nuk zvogëlojnë ose eliminojnë dobësitë në sistemet e menaxhimit dhe të kontrollit brenda afateve të caktuara.

gj) Autoriteti i auditit, në mënyrë që të monitorojë me sukses funksionimin e sistemeve të menaxhimit e të kontrollit, do të dorëzojë te ZKA-ja/NAO-ja planin auditues, vjetor, të punës dhe do të dërgojë raportin vjetor për aktivitetin e auditimit dhe opinionin vjetor të auditimit në ZKA/NAO.

h) Ministria e Financave, me qëllim zbatimin e përgjegjësive të ZKA-së/NAO-së, do të caktojë një person ose do të krijojë njësi organizative për auditim të brendshëm, duke siguruar funksionimin efektiv të sistemit të menaxhimit të fondeve të BE-së.

i) ZKA-ja/NAO-ja mundet, kur është e nevojshme, të angazhojë auditues të pavarur për të kryer auditim shtesë mbi të gjitha institucionet e përfshira në sistemin e menaxhimit të decentralizuar të fondeve të IPA-s, me qëllimin që të sigurojë funksionimin efektiv dhe efikas të sistemeve të menaxhimit e të kontrollit, në përputhje me IPA-n.

j) ZKA-ja/NAO-ja është përgjegjës për identifikimin e ndonjë parregullsie në kuadër të menaxhimit plotësisht të decentralizuar dhe për të informuar Komisionin European. ZKA-ja/NAO-ja bashkëpunon me strukturën përgjegjëse për parandalimin, zbulimin, raportimin dhe hetimin e parregullsive. Marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet ZKA-së/NAO-së dhe Shërbimit të Koordinimit kundër Mashtrimit (AFCOS-së) rregullohen në memorandumun e bashkëpunimit.

k) ZKA-ja/NAO-ja dorëzon një deklaratë vjetore garancie te Komisioni European, me një kopje të ZPA-së/CAO-së, në përputhje me nenin 17 të marrëveshjes kuadër. Nëse konfirmimi i funksionimit efektiv të sistemeve të menaxhimit e të kontrollit, si dhe konfirmi lidhur me ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve në fjalë, nuk janë të gatshme, ZKA-ja/NAO-ja informon Komisionin European dhe ZPA-në/CAO-në për arsyet dhe pasojat e mundshme të ngjarjes së ndodhur, si dhe masat e ndërmarra korrigjuese, me qëllim kapërcimin e saj dhe mbrojtjen e interesave të Bashkimit European.

l) ZKA-ja/NAO-ja siguron bashkëfinancimin e nevojshëm, në përputhje me marrëveshjet financiare IPA, në mënyrë që të parashikohet në buxhetin vjetor të Republikës së Shqipërisë.

ll) ZKA-ja/NAO-ja i paraqet Komisionit European një parashikim të aplikimeve të mundshme për pagesa, për vitin financiar në fjalë dhe për vitet financiare pasuese, më 28 shkurt të çdo viti.

m) ZKA-ja/NAO-ja merr pjesë në Komitetin Monitorues të IPA-s dhe Komitetin Monitorues të IPARD-së.

n) ZKA-ja/NAO-ja miraton manualin e brendshëm të procedurave për ZKA-në/NAO-në, zyrën e ZKA-së/NAO-së dhe Fondin Kombëtar dhe konfirmon manualin e brendshëm të procedurave të organeve që përbëjnë strukturën operative.

6. Fondi Kombëtar

a) Fondi Kombëtar është organ qendror thesari në Ministrinë e Financave, njësia e vetme nëpërmjet së cilës fondet e parazgjerimit të Bashkimit European do të transferohen në Republikën e Shqipërisë, sipas shkronjës "a" të pikës 4 dhe pikës 5 të aneksit A të marrëveshjes kuadër.

b) Drejtori i Fondit Kombëtar do të raportojë drejtpërdrejt te ZKA-ja/NAO-ja dhe është përgjegjës për funksionimin e performancën e veprimtarisë së Fondit Kombëtar.

c) Fondi Kombëtar, veprimet e të cilit menaxhohen nga ZKA-ja/NAO-ja, është përgjegjës për menaxhimin financiar të IPA-s dhe, brenda kompetencave të tij, kryen detyrat e mëposhtme:

i) hapjen dhe menaxhimin e llogarive bankare;

ii) kërkesën për fonde nga Komisioni European;

iii) miratimin e transferimit të fondeve nga Komisioni Europian te struktura operative ose te përfituesit përfundimtarë; si dhe

iv) dorëzimin e raporteve financiare në Komisionin Europian.

ç) Gjatë kryerjes së kompetencave të veta në lidhje me menaxhimin financiar të IPA-s, Fondi Kombëtar bashkëpunon me Bankën e Shqipërisë, ku ZKA-ja/NAO-ja hap llogari në monedhë të huaj, për kalimin e fondeve nga Komisioni Europian për secilin komponent të IPA-s. Marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet ZKA-së/NAOsë, Fondit Kombëtar, strukturës operative të IPARD-së dhe Bankës së Shqipërisë do të rregullohen nga një marrëveshje e veçantë, që përcakton termat dhe kushtet për funksionimin e llogarive të hapura në monedhë të huaj, me Bankën e Shqipërisë.

d) Ndarja e roleve dhe e përgjegjësiive ndërmjet ZKA-së/NAO-së, Fondit Kombëtar dhe strukturës operative, në kuadër të menaxhimit plotësisht të decentralizuar të IPA-s, komponenti V, dhe marrëdhëniet e tyre të ndërsjella, do të përcaktohen në memorandumun e mirëkuptimit, të nënshkruar ndërmjet Agjencisë së IPARD-së e ZKA-së/NAO-së dhe Autoritetit Menaxhues e ZKA-së/NAO-së, ku përshkruhen rolet dhe përgjegjësitë e palëve kontraktuese, procedurat e transferimit dhe metodat për shfrytëzimin e fondeve, dispozitat për bashkëfinancimin, mekanizmat e kontrollit financiar, menaxhimin e llogarive bankare, të kontabilitetit e të auditimit.

dh) Gjatë kryerjes së funksioneve, të listuara në këtë vendim, punonjësit e Fondit Kombëtar do të ndjekin dispozitat e Manualit të Brendshëm të Procedurave të Fondit Kombëtar, të miratuar nga ZKA-ja/NAO-ja dhe të konfirmuar nga ZPA-ja/CAO-ja.

7. Zyra e ZKA-së/NAO-së

a) Zyra e ZKA-së/NAO-së është strukturë e ngritur në Ministrinë e Financave, që raporton drejtpërdrejt te ZKA-ja/NAO-ja, me qëllimin për të mbështetur Zyrtarin Kombëtar Autorizues (ZKA-në/NAO-në) në kryerjen e funksionit të tij në lidhje me komponentin V të IPA-s (IPARD) dhe ushtrimin e funksionit të dytë të ZKA-së/NAO-së për funksionimin efektiv të sistemeve të menaxhimit e të kontrollit sipas rregullores implementuese IPA 718/2007, në zbatim të shkronjës “b” të pikës 4 të aneksit A të marrëveshjes kuadër, në përputhje me pikën 4 të nenit 25 të rregullores implementuese IPA 718/2007.

b) Zyra e ZKA-së/NAO-së do të mbështetë Zyrtarin Kombëtar Autorizues në kryerjen e detyrave të mëposhtme:

- i) të japë, të monitorojë dhe të pezullojë apo të tërheqë akreditimin e strukturës operative;
- ii) të sigurojë ekzistencën e funksionimit efektiv të sistemeve të menaxhimit të asistencës, sipas rregullores implementuese IPA 718/2007;
- iii) të sigurojë që sistemi i kontrollit të brendshëm për menaxhimin e fondeve është efektiv dhe efikas;

iv) të sigurojë që sistemi i duhur i raportimit dhe i informacionit funksionon;

v) të ndjekë gjetjet e raporteve të auditimit nga Autoriteti i Auditit, në përputhje me pikën 1 të nenit 30 të rregullores implementuese IPA 718/2007;

c) Zyra e ZKA-së/NAO-së bashkërendon aktivitetet e saj për sa i përket IPA-s, komponenti V – IPARD dhe përgatit materialet e nevojshme që duhen për këto aktivitete.

ç) Ndarja e roleve dhe e përgjegjësiive ndërmjet ZKA-së/NAO-së, zyrës së ZKA-së/NAO-së e strukturës operative dhe marrëdhëniet e tyre të ndërsjella, në kuadër të menaxhimit plotësisht të decentralizuar të IPA-s, komponenti V, do të përcaktohen në memorandumun e mirëkuptimit, të nënshkruar ndërmjet Agjencisë së IPARD-së e ZKA-së/NAO-së dhe Autoritetit Menaxhues e ZKA-së/NAO-së, ku përshkruhen rolet e përgjegjësitë për funksionimin efektiv të sistemeve të menaxhimit e të kontrollit dhe të sistemit të raportimit e të komunikimit.

d) Me kërkesë të ZKA-së/NAO-së, zyra e ZKA-së/NAO-së kryen kontrole në vend në agjencinë implementuese e në strukturat e IPA-s në ministrinë e linjës/institucionet përfituese, për monitorimin më të frytshëm të projekteve të financuara nën IPA-n, si dhe për të siguruar ligjshmërinë e rregullsinë e transaksioneve lidhur me to, në përputhje me pikën 4 të aneksit A të marrëveshjes kuadër dhe me nenin 25 të rregullores implementuese IPA 718/2007.

dh) Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, punonjësit e zyrës së ZKA-së/NAO-së zbatojnë dispozitat



e Manualit të Brendshëm të Procedurave për zyrën e ZKA-së/NAO-së, të miratuar nga ZKA-ja/NAO-ja dhe të konfirmuara nga ZPA-ja/CAO-ja.

8. Funksionet dhe përgjegjësitë e Autoritetit Menaxhues (MA)

a) Autoriteti menaxhues është përgjegjës për menaxhimin e programit IPARD, në përputhje me parimin e efikasitetit dhe efektivitetit të përdorimit të fondeve IPA.

b) Autoriteti menaxhues kryen këto detyra:

i) Përgatit programin e IPARD;

ii) Siguron që veprimet miratohen e financohen në përputhje me kriteret e mekanizmat që aplikohen për programet e IPARD-së dhe që ato janë në përputhje me rregullat përkatëse të Komisionit European e ato kombëtare, duke vlerësuar programin IPA nëpërmjet përmirësimit të cilësisë, të efektivitetit dhe të vijueshmërisë së fondeve IPA, si dhe në përputhje me strategjinë për implementimin e këtyre fondeve;

iii) Monitoron programin e IPARD-së dhe asiston punën e Komitetit Monitorues të IPARD-së, kryesisht duke dhënë dokumentet e nevojshme për monitorimin cilësor të implementimit të këtij programi;

iv) Përgatit raportet vjetore dhe finale të implementimit, duke u konsultuar me Agjencinë e IPARD-së dhe, pas verifikimit nga Komiteti Monitorues i IPARD-së, i dorëzon ato te Komisioni European, KKIPA-ja/NIPAC-ja dhe ZKA-ja/NAO-ja;

v) Jep informacion për ekzistencën e programit të IPARD-së dhe rregullat për zbatimin e tij, veçanërisht duke theksuar rolin e Komunitetit European dhe siguron transparencë për ndihmën e dhënë nga Bashkimi European;

vi) Krijon, mirëmban dhe përditëson sistemin e raportimit e të informacionit.

c) Autoriteti Menaxhues krijon një sistem për grumbullimin e informacionit financiar e statistikor mbi progresin e programit të IPARD-së, në qoftë se një sistem i tillë nuk është ngritur nga Agjencia e IPARD-së dhe ia dërgon këto të dhëna Komitetit Monitorues të IPARD-së, duke përdorur, kur është e mundur, sistemin kompjuterik për shkëmbimin e të dhënave me Komisionin European.

ç) Autoriteti Menaxhues i propozon Komisionit European dhe NIPAC-së, rregullimet e programit të IPARD-së pas konsultimeve me Agjencinë e IPARD-së dhe pas miratimit nga Komiteti Monitorues i IPARD-së. Autoriteti Menaxhues përgjigjet për sigurimin e informimit të autoriteteve përkatëse për të bërë ndryshimet administrative të nevojshme, kur duhet, si rezultat i një vendimi të Komisionit për të amenduar programin e IPARD-së.

d) Autoriteti Menaxhues harton, çdo vit, një plan pune për veprimet e parashikuara nën asistencën teknike, i cili i dorëzohet Komitetit Monitorues të IPARD-së për miratim.

dh) Autoriteti Menaxhues, çdo vit, i këshilluar nga Komiteti Monitorues i IPARD-së, konsultohet dhe informon Komisionin për nismat që janë marrë dhe ato që do të merren në të ardhmen lidhur me informimin e publikut për rolin e luajtur nga Bashkimi European në programin e IPARD-së dhe rezultatet e tij.

e) Autoriteti Menaxhues siguron që vlerësimet e programit të IPARD-së janë kryer në kohën e duhur, sipas marrëveshjes dhe në përputhje me kuadrin e monitorimit dhe vlerësimit të përbashkët.

ë) Autoriteti Menaxhues siguron përputhshmërinë lidhur me detyrimet për publicitetin, sipas nenit 24 të marrëveshjes kuadër.

f) Edhe kur një pjesë e detyrave i delegohen ndonjë organi tjetër, Autoriteti Menaxhues mban përgjegjësitë e plota për efikasitetin e korrektësinë e menaxhimit dhe implementimin e atyre detyrave.

9. Drejtuesi i Autoritetit Menaxhues

a) Drejtuesi i Autoritetit Menaxhues duhet të jetë brenda Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe do të jetë përgjegjëse për programimin dhe mbikëqyrjen e procesit të zbatimit të programit IPARD. Në të njëjtën kohë, ai/ajo do të jetë përgjegjës për bashkërendimin e aktiviteteve dhe përgjegjësitë e Autoritetit Menaxhues.

b) Drejtuesi i Autoritetit Menaxhues do të jetë përgjegjës për monitorimin, kontrollin dhe miratimin e aktiviteteve të Autoritetit Menaxhues, të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe të delegimit

të detyrave të caktuara tek organet e veçanta, të përmendura në pikën 2 të nenit 6 të marrëveshjes kuadër dhe duhet të marrë vendime bazuar në ushtrimin e funksioneve të përmendura në pikën 8 të këtij vendimi, për të cilat nuk ka vendosur Komiteti Monitorues i IPARD-së.

c) Drejtuesi i Autoritetit Menaxhues do të jetë ekskluzivisht përgjegjës për komunikimin me organet menaxhuese plotësisht të decentralizuara dhe do të bashkërendojë aktivitetet që lidhen me marrjen e akreditimit nga ZKA-ja/NAO-ja dhe transferimin e kompetencave menaxhuese nga Komisioni European.

ç) Drejtuesi i Autoritetit Menaxhues i dorëzon ZKA-së/NAO-së dhe KKIPA-së/NIPAC-së raporte të rregullta për zbatimin e aktiviteteve dhe përgjegjësitë të Autoritetit Menaxhues.

10. Funksionet dhe përgjegjësitë e Agjencisë IPARD

a) Agjencia e IPARD-së është përgjegjëse për implementimin e programit të IPARD-së, në përputhje me parimin e menaxhimit të shëndoshë financiar.

b) Agjencia e IPARD-së kryen detyrat implementuese dhe të pagesave, si më poshtë vijon:

i) bën thirrjet për aplikime dhe publikon termat dhe kushtet e pranueshmërisë;

ii) përzgjedh projektet; bën veprime kontrolli (*checking*), në përputhje me kriteret dhe mekanizmat e zbatuar nga programet e IPARD-së, në pajtueshmëri me rregullat përkatëse të Bashkimit European dhe ato kombëtare;

iii) verifikon aplikimet për miratimin e projekteve përkundrejt termave dhe kushteve të pranueshmërisë, në përputhje me marrëveshjet, duke përfshirë, ku është e përshtatshme, edhe dispozitat e prokurimeve publike;

iv) formulon, me shkrim, detyrimet kontraktuale ndërmjet Agjencisë së IPARD-së dhe përfituesit final, përfshirë edhe informacionin për sanksionet e ndryshme në raste të mospërbushjes së tyre dhe, kur është e nevojshme, jep miratimin për fillimin e punës;

v) vendos për zbatimin e skemës së grantit dhe siguron kontraktimin;

vi) kryen pagesat për përfituesit dhe kthen pagesat nga përfituesi final (në rastet e parregullsive);

vii) realizon kontrollet në terren për të verifikuar ligjshmërinë e projekteve para dhe gjatë miratimit të tyre;

viii) bën verifikime për të siguruar që shpenzimet e deklaruara janë kryer në përputhje me rregullat e aplikuara, që produkti apo shërbimi është dorëzuar në përputhje me vendimin e miratuar dhe kërkesa për pagesë nga përfituesi final është korrekte. Këto verifikime mbulojnë në mënyrë të rregullt aspektet e veprimeve financiare, administrative, teknike dhe fizike;

ix) ndjek zbatimin e projektit për të siguruar ecurinë e tij;

x) raporton për progresin e zbatimit të masave sipas indikatorëve;

xi) siguron që përfituesi final është njoftuar lidhur me kontributin e Bashkimit European në projekt;

xii) garanton raportimin e parregullsive;

xiii) siguron që ZKA-ja/NAO-ja, zyra e ZKA-së/NAO-së, Fondi Kombëtar, Autoriteti Menaxhues e kanë marrë të gjithë informacionin e nevojshëm për të kryer detyrat e tyre.

c) Për sa u përket investimeve në projektet e infrastrukturës, të atyre që normalisht pritet të gjenerojnë të ardhura neto të konsiderueshme, Agjencia e IPARD-së vlerëson, përpara hyrjes në një marrëveshje kontraktuale me përfituesin potencial, nëse projekti është i këtij lloji. Kur konkludohet që projekti është i tillë, Agjencia e IPARD-së garanton që ndihma publike nga të gjitha llojet e burimeve nuk i kalon 50% të koston totale lidhur me projektin dhe konsiderohet e pranueshme për bashkëfinancimin e Bashkimit European.

ç) Për sa u përket investimeve në projekte, përveç atyre të infrastrukturës, që nuk gjenerojnë të ardhura neto të konsiderueshme, Agjencia e IPARD-së duhet të sigurojë që, për çdo projekt të programit të IPARD-së, grumbullimi i grantit të ndihmës publike nga të gjitha burimet, nuk e kalon maksimumin e tavanëve për shpenzimet publike, të vendosura në Fondin Kombëtar dhe Agjencinë e IPARD-së apo në ndonjë nga organet e deleguara prej tyre dhe të ketë një sistem të veçantë kontabiliteti ose kode të veçanta kontabiliteti, që janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

d) Agjencia e IPARD-së akreditohet nga Zyrtari Kombëtar Autorizues (ZKA/NAO) dhe



kompetencat menaxhuese jepen nga Komisioni Europian për përdorimin e fondeve të IPA-s, në komponentin V.

11. Drejtuesi i Agjencisë së IPARD-së

a) Drejtuesi i Agjencisë së IPARD-së është përgjegjës ndaj ministrit të Buqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Zyrtarit Kombëtar Autorizues, për përdorimin e fondeve të IPA-s për komponentin V.

b) Drejtuesi i Agjencisë së IPARD-së duhet të raportojë për veprimtarinë e kësaj agjencie te Zyrtari Kombëtar Autorizues për përdorimin e fondeve të IPA-s për komponentin V.

12. Autoriteti i Auditit

Autoriteti i Auditit është një strukturë funksionalisht e pavarur nga të gjithë aktorët në sistemin e menaxhimit dhe kontrollit, në përputhje me standardet e auditimit të pranuar ndërkombëtarisht, e krijuar me vendimin nr. 1020, datë 14.10.2009 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës të Bashkimit Europian”, të ndryshuar.

13. Komiteti i Monitorimit të IPARD-së

a) Në përputhje me nenin 36 të marrëveshjes kuadër të IPA-s, Komiteti i Monitorimit të IPARD-së duhet të krijohet brenda gjashtë muajve pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes së parë financuese, pas konsultimit me Komisionin dhe partnerët e referuar në nenin 59 të marrëveshjes sektoriale.

b) Komiteti i Monitorimit të IPARD-së duhet t’i raportojë Komitetit të Monitorimit të IPA-s dhe duhet të sigurohet për efektivitetin e cilësinë e zbatimit të programit të IPARD-së, në mënyrë që të arrijnë objektivat e programit.

c) Komiteti i Monitorimit të IPARD-së do të përbëhet nga përfaqësuesit e autoriteteve dhe organeve përkatëse, të tillë si: KKIPA/NIPAC, ZKA/NAO, zyra e ZKA-së/NAO-së, Fondi Kombëtar, Agjencia e IPARD-së, Autoriteti Menaxhues dhe Komisioni Europian, si dhe partnerët e duhur ekonomikë, socialë e mjedisorë. Ky Komitet do të kryesohet nga një përfaqësues i Republikës së Shqipërisë, me kusht që personi i caktuar nuk duhet të jetë punonjës i Agjencisë së IPARD-së. Komiteti i Monitorimit të IPARD-së, në konsultim me Autoritetin Menaxhues, Agjencinë e IPARD-së dhe Komisionin, do të hartojë dhe do të miratojë procedurat e rregullave të tij. Të gjitha ndryshimet përkatëse do t’i komunikohen paraprakisht Komisionit.

ç) Komiteti i Monitorimit të IPARD-së duhet të kryejë të gjitha funksionet dhe detyrat e tij në përputhje me nenin 61 të marrëveshjes “Mbi rregullat për bashkëpunimin lidhur me asistencën financiare të BE-së kundrejt Shqipërisë dhe zbatimit të asistencës nën komponentin V (IPARD) të Instrumentit të Ndhmës së Paraaderimit (IPA)”

14. Shërbimet e auditimit të brendshëm

a) Drejtuesi i Agjencisë së IPARD-së, në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave për krijimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, kujdeset për kryerjen e auditimit të brendshëm. Për realizimin e këtij auditimi duhet të krijohet një njësi e veçantë.

b) Njësia organizative e auditimit të brendshëm, nëpërmjet drejtuesit të Agjencisë së IPARD-së, i raporton, Zyrtarit Kombëtar Autorizues për veprimtarinë vjetore audituese, jo më vonë se data 10 shkurt, pas përfundimit të periudhës përkatëse raportuese.

c) Shërbimi i auditimit të brendshëm në Autoritetin Menaxhues do të kryhet nga audituesit e brendshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

ç) Njësia e auditimit të brendshëm në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, nëpërmjet drejtuesit të Autoritetit Menaxhues, i raporton ZKA-së për rezultatet e auditimeve të kryera jo më vonë se data 10 shkurt, pas përfundimit të periudhës përkatëse raportuese. Me kërkesë të ZKA-së/NAO-së, Autoriteti Menaxhues paraqet, gjithashtu, edhe raporte të tjera.

d) Audituesit e brendshëm të Ministrisë së Financave, të emëruar për auditimin e strukturave menaxhuese të fondeve të IPA-s (ZKA/NAO dhe Fondi Kombëtar), duhet t’i dorëzojnë ZKA-së raportin vjetor të auditimeve të kryera deri më 10 shkurt të çdo viti për vitin e kaluar. Me kërkesë të ZKA-së/NAO-së, audituesit e brendshëm të Ministrisë së Financave do të paraqesin raporte të tjera.

dh) Gjatë vitit, Agjencia e IPARD-së dhe Autoriteti Menaxhues i dërgojnë ZKA-së/NAO-së informacion për monitorimin e rekomandimeve të auditit.

e) Tabelat për rekomandimet e dhëna nga auditimi i brendshëm duhen përditësuar çdo muaj nga Agjencia e IPARD-së dhe Autoriteti Menaxhues dhe një kopje t'i dërgohet ZKA-së/NAO-së.

15. Përcaktimi i funksioneve Alpha

a) Organet e menaxhimit plotësisht të decentralizuar dhe strukturat brenda Ministrisë së Financave do të kryejnë funksionet dhe përgjegjësitë e tyre në përputhje me rregullat e brendshme të Ministrisë së Financave.

b) Organet e menaxhimit plotësisht të decentralizuar dhe strukturat brenda Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit do të kryejnë funksionet dhe përgjegjësitë e tyre në përputhje me rregullat e brendshme të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

c) Organet e menaxhimit plotësisht të decentralizuar dhe strukturat brenda Agjencisë së IPARD-së do të kryejnë funksionet dhe përgjegjësitë e tyre brenda autorizimeve të Agjencisë së IPARD-së.

16. Parashikime të fundit

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave janë përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 847, datë 4.12.2012

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME, PËR WESTMINSTER COUNCIL, PËR PROJEKTIN “VENDOSJA E BUSTIT TË SKËNDERBEUT NË LONDËR, NË NËNTOR 2012”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punëve të Jashtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në programin 01120, “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit”, t'i shtohet fondi prej 4 130 719 (katër milionë e njëqind e tridhjetë mijë e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë) lekësh, për Westminster Council, për realizimin e projektit “Vendosja e bustit të Skënderbeut në Londër, në nëntor 2012”.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi nr. 736, datë 2.11.2012 i Këshillit të Ministrave “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për projektin “Vendosja e bustit të Skënderbeut në Londër, në nëntor 2012”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 26, datë 13.11.2012

PËR RINOVIM LICENCE SHA “UJËSJELLËS PESHKOPI”

Në mbështetje të nenit 14 pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për efekt të përfundimit të afatit dhe të ndryshimit të drejtuesit ligjor operatorit sh.a. Ujësjellës Peshkopi me:

Drejtues ligjor: z. Bedri Maliq Kamberi

Drejtues teknik: z. Dritan Abdulla Nuzi

2. Operatori sh.a. “U Peshkopi” autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A, për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është:

Bashkia: Peshkopi

Komunat: Tomin, Kastriot, Slllove, Fushë-Çidhen, Kala e Dodës, Luzni.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare, deri në datën 12.11.2016.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM
Nr. 27, datë 13.11.2012

PËR RINOVIM LICENCE SHA “UJËSJELLËS-KANALIZIME” KRUIJË

Në mbështetje të nenit 14 pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për efekt të mbarimit të afatit operatorit sh.a. ujësjellës-kanalizime Krujë me:

Drejtues ligjor: z. Luan Ali Emiri

Drejtues teknik: z. Alfred Faik Avllaj

2. Operatori sh.a. “UK Krujë” autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A: për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

Kategoria C: për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është:

Bashkia: Krujë

Komuna: Cudhi

Fshati: Picrrage

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare, deri në datën 12.11.2016.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM
Nr. 28, datë 19.11.2012

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHA “UK
POGRADEC”**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102 datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe “Metodologjisë mbi vendosjen e tarifave”, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

VENDOSI:

1. Të miratojë për sh.a. “UK Pogradec” tarifatat si më poshtë:

a) Për shërbimin e furnizimit me ujë:

	Bloku i parë deri në 4.5 m³	Bloku i dytë mbi 4.5 m³	Tarifa fikse lekë/muaj
- konsumator familjar lekë/m ³	22	62	200
- institucione buxhetore lekë/m ³	37	111	400
- ente private	37	111	400
b) Për shërbimin e largimit ujërave të ndotura:			
- konsumator familjar lekë/m ³	11	33	100
- institucione buxhetore lekë/m ³	12	36	100
- ente private	12	36	150

2. Objektivat e treguesve të performancës të shoqërisë për vitin 2013:

- uji pa të ardhura (humbjet)	32 %
- niveli i matjes	95 %
- kohëzgjatja e furnizimit	21.5 orë/ditë
- eficienta e energjisë	0.53 kwh/m ³
- efikasiteti i stafit	3.65 p/000 lidhje
- mbulimi me ujë	99 %
- mbulimi me kanalizime	78 %
- norma e arkëtimit	90 %
- cilësia e ujit (klor+koliform)	sipas standardeve

3. Pagesa rregullatore për sh.a. “UK Pogradec” do të jetë 0.8% e të ardhurave vjetore të llogaritura.

4. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2013 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 2427, datë 17.10.2012, shpall heqjen e zotësisë për të vepruar për shtetasin Ndriçim Hida, i biri i Rexhepit dhe i Xhemiles, i datëlindjes 26.6.1951, lindur dhe banues në fshatin Lukan, Gjinar Elbasan, duke caktuar si kujdestar për të vëllain e tij, shtetasin Bashkim Hida, i datëlindjes 3.4.1959, lindur dhe banues në fshatin Lukan, të komunës Gjinar Elbasan.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 12.12.2012
Doli nga shtypi më 14.12.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 42 lekë